

MEMORIALIZIMI



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo

ROLI DHE
RËNDËSIA E TIJ
NË BALLAFAQIMIN
ME TË KALUARËN



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

MEMO RIA LIZIMI

ROLI DHE
RËNDËSIA E TIJ NË
BALLAFAQIMIN ME
TË KALUARËN



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

Botuesi:
Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë

Për botuesin:
BEKIM Blakaj

Përgatiti:
BESNIK Beqaj, VESA Qena

Dizajni grafik dhe ilustrimet:
DARDAN Luta



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo

Copyright © 2022
Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë

hlc-kosovo.org

PËRMBAJTTJA

Rreth Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë	07
Hyrje	08
1. MEMORIALIZIMI, roli dhe rëndësia e tij në shtetet dhe shoqëritë në tranzicion	09
2. KONTEKSTI I KOSOVËS	10
3. MEMORIALIZIMI NË KOSOVË	10
3.1. Rregullimi Ligjor	10
3.2. Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës	11
3.3. Praktika e Memorializimit në Kosovë	12
4. PËRFUNDIME	15
5. REKOMANDIME	16
6. SHËNJIMI I VENDEVE TË KRIMIT	18
6.1. Burgu i Smrekonicës/Smrekovnica	21
6.2. Spitali i Prishtinës/Priština	31
6.3. Ura e Lluzhanit/Lužane	41
6.4. Xhamia e Krushës së Madhe/Velika Kruša	51
6.5. Varrezat Masive	61
6.6. Stacioni i Autobusëve në Fushë Kosovë/Kosovo Polje	73
6.7. Kufiri me Shqipërinë	83
6.8. Shtëpia afër Varrezave në Vushtrri/Vučitrn	93
6.9. E ashtuquajtura "Gropa për Bërlllog" në Rahovec/Orahovac	103
6.10. Bunari i papërfunduar në Gradicë/Gradica	113
6.11. Ura e Gegëve në Pejë/Peć	121
6.12. Shtëpia e Kulturës në Glllogoc/Glogovac	131
7. BURIMET	141

PRETH FONDIT PËR TË DREJTËN HUMANITARE KOSOVË

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë (FDH Kosovë) është themeluar në Prishtinë në maj të vitit 1997, nga aktivistja e të drejtave të njeriut, znj. Natasha Kandiç, si degë e Fondit për të Drejtën Humanitare.

Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë vepron si një organizatë e pavarur që nga prilli i vitit 2011. FDH Kosovë vazhdimisht kontribuon në aftësimin e Kosovës për të vendosur sundimin e ligjit dhe zbatimin e mekanizmave të drejtësisë tranzicionale, në mënyrë që të zhvillojë një shoqëri të drejtë që përballet me të kaluarën dhe i respekton të drejtat e çdo qytetari.

FDH Kosovë punon në dokumentimin e fakteve, të cilat e ndihmojnë shoqërinë e Kosovës të ballafaqohet me të kaluarën e saj të dhunshme. Organizata synon t'i kundërvihet mohimit dhe manipulimit politik të humbjeve njerëzore, dhe e synon sigurimin e integritetit dhe transparencën e gjykimeve të krimeve të luftës.

Deri në shpërthimin e armiqësive midis forcave të sigurisë serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në shkurt të vitit 1998, FDH Kosovë ishte e fokusuar në dokumentimin e represionit policor ndaj shqiptarëve të Kosovës, duke hetuar rastet e torturës, të ndalimit të paligjshëm, ftesave masive të shqiptarëve për "biseda informative", dhe gjykimet politike. Pas intensifikimit të konfliktit, FDH Kosovë zhvendosi vëmendjen në dokumentimin e vrasjeve dhe zhdukjeve të shqiptarëve të Kosovës, si dhe zhdukjen e grupeve të tjera etnike. Pas ndërhyrjes së NATO-s në vitin 1999, FDH Kosovë ka lëvizur zyrën e saj në Mal të Zi, ku ka vazhduar punën e dokumentimit me shqiptarët e Kosovës, të cilët ishin dëbuar nga Kosova.

Me arritjen e marrëveshjes së paqes të vitit 1999, që i dha fund luftës, FDH Kosovë u kthye në Prishtinë dhe e filloi dokumentimin e krimeve të kryera nga forcat serbe gjatë ndërhyrjes së NATO-s. Pas vendosjes së administratës ndërkombëtare në Kosovë, FDH Kosovë filloj të hetoj rrëmbimet, zhdukjet dhe vrasjet e serbëve, ash-kalinjëve, boshnjakëve dhe shqiptarëve.

Sot, FDH Kosovë vazhdon përpjekjet e saj për monitorimin e procedurave gjyqësore në lidhje me pasojat e konfliktit të fundit. Përveç monitorimit dhe raportimit mbi gjykimet, FDH Kosovë përfshihet në mënyrë aktive edhe në gjetjen e viktimave dhe përfaqëson familjet e tyre në gjykatat në Kosovë dhe Serbi. Elementi i tretë themelor i aktiviteteve të FDH Kosovë është përhapja e njohurive mbi drejtësinë tranzicionale brenda komuniteteve profesionale dhe jo-profesionale.

HYRJE

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit "Promovimi i Dialogut dhe Mirëkuptimit Historik", i cili është përkrahur nga fondacioni 'The National Endowment for Democracy' (NED). Projekti synon të kapërcejë boshllëkun e njohurive që ekzistojnë në mesin e të rinjve në Kosovë për konfliktin e fundit në Ballkan, si dhe të bëjë përkujtimin e viktimave civile nga të gjitha përkatësitë etnike në mbarë Kosovën.

Publikimi është i ndarë në dy pjesë kryesore. Në pjesën e parë të tij është bërë një analizë rreth rëndësisë së procesit të memorializimit dhe mënyrës se si është duke u praktikuar një proces i tillë në Kosovë lidhur me ngjarjet e luftës së fundit gjatë viteve 1998-1999. Kurse pjesa e dytë e publikimit ndërlidhet me rëndësinë e shën-jimit të vendeve të krimit në procesin e ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë dhe në total janë përmbledhur 12 lokacione, në të cilat kanë ndodhur shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe nuk janë shënjuar deri me tani. Të dy pjesët janë rezultat i një pune dy vjeçare të stafit të FDH Kosovë.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë dhe nuk pasqyron pikëpamjet e fondacionit 'The National Endowment for Democracy'.

1. MEMORIALIZIMI

ROLI DHE RËNDËSIA E TIJ NË SHTETET DHE SHOQËRITË NË TRANZICION

Memorializimi, përmes formave të ndryshme të manifestimit siç është ngritja dhe vendosja e memorialeve, e qendrave kërkimore dhe arkivore, e muzeve, dokumentacionit dhe e formave të tjera të ngjashme, zë një vend me rëndësi në procesin e ballafaqimit me të kaluarën (Toma, 2020, fq.11). Megjithatë, proceset e memorializimit nuk janë të orientuara vetëm nga e kaluara duke kujtuar ngjarjet, duke mundësuar lidhjen e historive dhe duke i njohur dhe nderuar viktimat, por kanë rëndësi të barabartë me të tashmen duke kontribuar në procesin e shërimit dhe në rindërtimin e besimit midis komuniteteve dhe me të ardhmen duke kontribuar në parandalimin e dhunës së mëtejshme përmes edukimit dhe ndërgjegjësisë (A.HRC/25/49, 2014, para.13). Gjithashtu, memorializimi është një proces thelbësor për rikuperimin nga trauma dhe mizoritë, ku, ndër mënyrat e shumta të adresimit të së kaluarës përmes drejtësisë tranzicionale, memorializimi ka mundësi të përfshijë numër më të madh njerëzish për periudha me të gjata kohore dhe të iniciohet në mënyrë të barabartë si nga komunitetet ashtu edhe nga qeveritë (Hamber et al, 2010, fq.398).

Studiuesit Barsalou dhe Baxter konsiderojnë që proceset e kujtesës kolektive të kujtimit dhe nderimit nuk duhet të transmetohen vetëm si drejtësi e fitimtarëve, por duhet të transmetojnë një proces reflektimi për të kaluarën. Pastaj, të njëjtit e theksojnë që të mbijetuarit duhet të përfshihen drejtpërdrejtë në diskutimin se çfarë duhet të përkujtohet dhe si. Dhe, në fund, memorializimi duhet të konsiderohet si një politikë dhe proces afatgjatë në shtetet në tranzicion (Barsalou & Baxter, 2007, fq.13). Në rastet kur parime të tilla nuk merren në konsideratë, procesi i memorializimit në shoqëritë pas konflikteve mund ta dëmtoj ndjeshëm procesin e ballafaqimit me të kaluarën drejt ndërtimit të një paqeje të qëndrueshme dhe për të garantuar mospërsëritjen (Toma, 2020, fq.11; Baliqi, 2017, fq.5). Prandaj, memorializimi duhet të ketë një vend me rëndësi në proceset e ballafaqimit me të kaluarën në krimin e kujtesës kolektive duke u bazuar në fakte, të promovojë paqen dhe pajtimin mes shoqërive të ndara.

2. KONTEKSTI I KOSOVËS

Shpërbërja e ish-Jugosllavisë u përcoll me konflikte të shumta të armatosura gjatë viteve të 90-ta dhe të njëjtat u karakterizuan me shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Konflikti i armatosur në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, shkaktoi viktimë të shumta, dëme të mëdha materiale dhe gjithashtu solli një realitet krejt të ri sa i përket statusit politik të Kosovës, e cila nga një Krahinë Autonome e ish-Jugosllavisë kaloi nën administrimin ndërkombëtar dhe pastaj në vitin 2008 e shpalli edhe pavarësinë duke u shndërruar në një republikë parlamentare. Kosova, për momentin, ka një popullsi pothuajse të ndarë në vija etnike si pasojë e ngjarjeve që ndodhën në fund të viteve të 80-ta dhe përgjatë viteve të 90-ta e të cilat ndikuan edhe në prishjen e raporteve mes grupeve etnike që banojnë në Kosovë e sidomos mes shqiptarëve dhe serbëve.

Sipas të dhënave preliminare të Libër Kujtimit të Kosovës, si pasojë e konfliktit gjatë viteve 1998-1999 dhe pas përfundimit të luftës deri në fund të vitit 2000, 13.535 persona janë vrarë dhe/apo janë zhdukur me dhunë. Nga numri përgjithshëm i viktimave, 10.317 ishin civilë (prej tyre 8676 shqiptarë, 1196 serbë dhe 445 nga grupet e tjera etnike) dhe 3218 nga forcat e ndryshme të armatosura (prej tyre 2131 nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, 1084 nga forcat e armatosura serbe dhe jugosllave dhe 3 nga forcat e NATO-s). Në anën tjetër, mbi 1600 persona ende rezultojnë të zhdukur.

Periudha e viteve 1998-1999 u përcoll edhe me zhvendosje të madhe të popullsisë brenda vendit dhe në shtetet e rajonit. Mbi 1 milion qytetarë të Kosovës u detyruan me dhunë të lëshojnë vendin. Vetëm gjatë 9 javëve të para pas fillimit të intervenimit të NATO-s në ish-Jugosllavi më shumë se 860.000 persona u regjistruan si refugjatë në shtetet e rajonit (prej tyre 444.600 në Shqipëri, 344.500 në Maqedoni dhe 69.900 në Mal të Zi) (UNHCR, 2000, fq.7). Ndërsa menjëherë pas përfundimit të luftës, në muajin qershor dhe muajt pasues të vitit 1999, mbi 200.000 serbë, romë dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera pakicë u larguan nga Kosova (UNHCR, 1999, fq.6).

3. MEMORIALIZIMI NË KOSOVË

RREGULLIMI LIGJOR

Në nivelin qendror janë momentalisht dy ligje dhe një rregullore që në përmbajtje rregullojnë çështje që ndërlidhen me memorializimin e ngjarjeve të luftës në Kosovë gjatë

viteve 1998-1999. Bazuar në Ligjin Nr. 04/L-146 Për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, përgjegjësitë e përgjithshme për projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e komplekseve përkujtimore mbështeten në këtë agjenci (Ligji Nr. 04/L-146, 2013). Në anën tjetër, statusi i Kompleksit Memorial "Adem Jashari" është i rregulluar me ligj të veçantë, i cili rregullon statusin dhe obligimet shtetërore ndaj kompleksit dhe përcakton se ky memorial ka rëndësi ontologjike, antropologjike, historike, kulturore dhe civile për Skenderajn/Srbica, Drenicën, Kosovën dhe mbarë kombin shqiptar (Ligji Nr. 06/L-059, 2018). Qeveria e Kosovës ka hartuar edhe një rregullore se si duhet vepruar gjatë vizitës së këtij kompleksi memorial, e cila përcakton rregullat dhe mënyrat e sjelljes së vizitorëve në hapësirat e Kompleksit Memorial "Adem Jashari" në Prekaz (Rregullorja nr. 01/2021, 2021).

Sa i përket nivelit lokal, procedurat dhe kriteret për proceset e memorializimit rregullohen nga secila komunë në bazë të kompetencave që dalin nga ligji për pushtetin lokal (Ligji nr. 03/L-040, 2008). Procedurat dhe kriteret e tilla për përkujtime parashikohen në rregullore konkrete, të cilat parashikojnë një sërë rregullash, kushtesh dhe sanksionesh për aktivitetet për përkujtimin e ngjarjeve me rëndësi kolektive dhe përkujtimore (shembull: R-01-331/12-K.VU, 2012) .

AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës është organ i pavarur, i themeluar nga institucionet e nivelit qendror të Kosovës, përgjegjëse për projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e komplekseve memoriale në tërë territorin e Kosovës (Ligji Nr. 04/L-146, 2013). Kjo agjenci ka një regjistër të mbi 1300 memorialeve që janë ndërtuar në Kosovë dhe shumica prej tyre ndërlidhen me luftën që ndodhi gjatë viteve 1998-1999. Një regjistër i tillë mund të gjendet lehtësisht në faqen e saj zyrtare dhe përfshin memorialet që janë ndërtuar nga familjet e viktimave, nga grupet e organizuara të shoqërisë, nga komunat dhe nga shteti (webfaqe - <https://amkmk.rks-gov.net/> ; Haxhijaj, 2021). Krijimi i këtij regjistri është i mirëseardhur dhe ofron një pasqyre të përgjithshme mbi numrin dhe lokacionin e memorialeve në tërë territorin e Kosovës dhe i njëjti është një burim i rëndësishëm informacioni për

grupet e ndryshme të interesit dhe publikun e gjerë. Megjithatë, regjistri i memorialeve karakterizohet nga disa mangësi të cilat janë duke e dëmtuar procesin e krijimit të një kujtese kolektive, e cila kontribuon në paqe të qëndrueshme, si:

- Memorialet, që janë pjesë e regjistrit, zakonisht përfshijnë vetëm një fotografi dhe vendin ku janë vendosur dhe vetëm një numër i vogël prej tyre përmbajnë një informacion më të gjerë, si: kur janë ndërtuar, nga kush dhe pse janë ndërtuar. Duke pasur parasysh këtë, shumica e memorialeve nuk kanë informacione bazë lidhur me ngjarjen për të cilën është ngritur memoriali;

- Agjencia ka përfshirë në regjistrin e saj memorialë që përfshijnë informacione të pasakta dhe promovojnë urrejtje në baza etnike;

- Agjencia ka përfshirë në regjistrin e saj vetëm memorialet që iu kushtohen shqiptarëve. Pra, nga regjistri dhe përkujdesja e agjencisë janë përjashtuar memorialet përkujtimore që iu kushtohen anëtarëve të komuniteteve të tjera, si serbëve, romëve, egjiptianëve, dhe grupeve të tjera etnike. Në këtë mënyrë ofrohet një qasje e njëanshme dhe në kundërshtim me parimet e mos-diskriminimit në baza etnike.

PRAKTIKA E MEMORIALIZIMIT NË KOSOVË

Memorializimi i duhur lidhur me ngjarjet e luftës në Kosovë gjatë viteve 1998-1999 vazhdon të mbetet jashtë vëmendjes të institucioneve përkatëse të Kosovës. Procesi i përkujtimit të së kaluarës vazhdon të karakterizohet me ndërtimin e busteve, pllakave përkujtimore dhe emërtimeve të rrugëve dhe objekteve publike në nderim të figurave të ndryshme dhe ekziston një praktikë e mos-respektimit të rregulloreve komunaleve lidhur me procesin e ngritjes së këtyre memorialeve. Në anën tjetër, në Kosovë akoma nuk është ndërtuar ndonjë muze i luftës, i cili do të kontribuonte në pasurimin e kujtesës kolektive të shoqërisë kosovare lidhur me ngjarjet e luftës së fundit. Gjithashtu mungojnë qendra kërkimore dhe arkivore të qasshme për publikun e gjerë. Në përgjithësi, memorializimi në Kosovë karakterizohet me fokus në heroizmin e luftës së UÇK-së; mungon përkujtimi i duhur i viktimave civile; fokusi në përkujtimin heroik të

burrave dhe në përkujtimin e grave vetëm si viktimë; mungon një praktikë gjithëpërfshirëse në baza etnike dhe memorializimi karakterizohet me përmbajtje të pasaktë dhe promovim të gjuhës së urrejtjes.

Fokusi në grupet e armatosura: Siç u përmend më lart, më shumë se 10.000 persona që u ekzekutuan dhe/apo u zhdukën me forcë ishin viktimë civile. Por, praktika e memorializimit në Kosovë po vazhdon me qasje të kundërt në raport me këto fakte. Memorialet dhe narrativat publike të pasluftës në Kosovë vazhdojnë të përqendrohen “në heroizmin e ushtarëve të rënë dhe në sakrificën për ‘luftën çlirimtare’ të të mbijetuarve të luftës” (Baliqi, 2017, fq.2). Në çdo qytet mund të vërehen buste të mëdha, memoriale dhe pllaka përkujtimore kushtuar pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilat janë iniciuar dhe financuar nga institucionet shtetërore dhe nga grupet e tjera të shoqërisë. Fokusi tek forcat e armatosura vihet re edhe në përmasat, vendin dhe vëmendjen që i kushtohet këtyre të fundit. Çfarë do të thotë kjo? Për shembull, në sheshin kryesor të Prishtinës mund të vërehet lehtësisht shtatorja e ish komandantit të UÇK-së Zahir Pajaziti, sepse është e madhe, e vendosur mirë dhe e ka vëmendjen në shumë ditë përkujtimore, por, nga ana tjetër, vështirë se mund të vërehet memoriali kushtuar personave të zhdukur, sepse është shumë më i vogël, i vendosur në një cep të sheshit dhe zakonisht vizitohet nga institucionet shtetërore vetëm në datën 27 Prill – ditën kombëtare të personave të pagjetur.

Mungesa e vëmendjes në përkujtimin e viktimave civile: Viktimat civile vazhdojnë të kenë mungesë të vëmendjes së duhur nga institucionet shtetërore në procesin e përkujtimit. Shumica e iniciativave përkujtimore kushtuar civilëve janë iniciuar dhe mbështetur nga familjet e tyre, nga komuniteti i tyre, nga bizneset lokale ose nga organizatat joqeveritare. Institucionet shtetërore janë fokusuar më së shumti në rregullimin e varrezave të viktimave civile, por edhe në këtë pjesë kanë dështuar në shumë raste: si shembull mund të përmendim varrezat e Masakrës së Mejës/Meja, e cila është masakra më e madhe në luftën në Kosovë, por deri më sot varrezat e kësaj masakre nuk janë përfunduar ende. Drejtësia tranzicionale promovon pozitë qendrore për viktimat në të gjithë mekanizmat e saj. Andaj, memorializimi, si një nga mekanizmat e drejtësisë tranzicionale, duhet të kontribuojë në përkujtimin dhe në nderimin e viktimave, duke kontribuar, kështu, në njohjen e humbjeve dhe të dhimbjes së tyre dhe, gjithashtu, përkujtimi duhet të shërbejë si një formë e dëmshpërblimit simbolik për viktimat.

Gratë si viktimat në kujtesën kolektive: Gratë, nga ana tjetër, vazhdojnë të përkujtohen vetëm si viktimat dhe jo edhe për kontributin e tyre në formë të ndryshme. Memoriali HEROINAT, i cili është ndërtuar në vitin 2015 dhe i kushtohet viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, është një memorial që më së shumti ndërlidhet me përkujtimin e grave gjatë luftës dhe është një shembull se si gratë vazhdojnë të përkujtohen vetëm si viktimat të luftës. Në anën tjetër, janë një numër i memorialeve që iu dedikohen grave si ish-pjesëtare të UÇK-së, por që nuk marrin vëmendjen e duhur si edhe memoriali Heroinat në ditët përkujtimore. Një praktikë e tillë është duke ushqyer ndërtimin e një kujtese kolektive në shoqërinë kosovare ku grave nuk iu njohet kontributi i tyre në luftën e fundit të viteve të 90-ta.

Mungesë e qasjes gjithëpërfshirëse në baza etnike: Një mangësi tjetër e procesit të memorializimit në Kosovë është mungesa e qasjes gjithëpërfshirëse bazuar në përkatësinë etnike. Siç u përmend më lart, memorialet kushtuar viktimave joshqiptare nuk janë të regjistruara dhe nuk menaxhohen nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale në Kosovë. Në anën tjetër, janë paraqitur raste ku viktimat të caktuara përjashtohen nga memorialet e sponsorizuara nga institucionet komunale, siç është rasti i një vajze romë që nuk është përfshirë në grupin e viktimave, të cilat ishin të cekura në një pllakë përkujtimore (FDH Kosovë, 2020). Një rast tjetër është edhe memoriali kushtuar viktimave që humbën jetën në urën e Lluzhanit, kur autobusi u godit nga një predhë në vitin 1999 – në pllakën që është financuar nga komuna e Podujevës/Podujevo janë përjashtuar viktimat serbe. (Fazliu & Robinson, 2021). Memorialet kushtuar viktimave joshqiptare gjithashtu nuk vizitohen nga përfaqësuesit e shtetit në ditët e tyre përkujtimore.

Gjithëpërfshirja në përkujtim promovohet nga Organizatat Jo-Qeveritare, duke kritikuar rastet si ato që u përmendën më lart, duke ndërgjegjësuar qytetarët për rëndësinë e gjithëpërfshirjes dhe, gjithashtu, duke sjellë në jetë iniciativë përkujtimore që promovojnë gjithëpërfshirjen si:

- Ekspozita “Na ishte një herë që kurrë mos qoftë”, një ekspozitë kushtuar 1133 fëmijëve të vrarë dhe/apo zhdukur si pasojë e luftës në Kosovë. Kjo ekspozitë është hapur në vitin 2019 në ambientet e Qendrës së Dokumentimit Kosovë (DCK) realizuar

nga FDH Kosovë dhe shërben si një memorial përkujtimi për të gjithë fëmijët që kanë humbur jetën si pasojë e luftës pa dallime etnike. (FDH Kosovë, 2019).

- "Muzeu Virtual i Refugjatëve", një përmbledhje e rrëfimeve personale të individëve nga grupe të ndryshme etnike, të cilët shpalosin përvojat e tyre personale gjatë periudhës sa ishin të zhvendosur si refugjatë si pasojë e luftës në Kosovë. Kjo platformë është krijuar në vitin 2021 nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut Kosovë (YIHR-KS, 2021).

- "Toka e Hidhur", një bazë e të dhënave interaktive, e cila përmban lokacionin e saktë të një numri të madh të varrezave masive që janë zbuluar deri më tani në gjithë hapësirën e ish-Jugosllavisë. Përveç lokacionit të varrezave, kjo platformë ofron informacione lidhur me identitetin e trupave që janë gjetur në të njëjtat, përgjegjësit e krimeve dhe informacione të tjera bazuar në një qasje gjithëpërfshirëse. Një platformë e tillë është krijuar në vitin 2021 nga Balkan Investigative Reporting Network (BIRN, 2021).

Promovimi i urrejtjes: Gjuha në memoriale është një tjetër çështje që duhet të trajtohet në Kosovë. Memorialet karakterizohen me gjuhë nacionaliste dhe gjuhë të urrejtjes. Fjalitë si "të vrarë nga kriminelët serbë", "të ekzekutuar nga forcat çetnike serbe", "të vrarë nga terroristët shqiptarë", "të ekzekutuar nga terroristët e UÇK-së", "të vrarë nga agresioni i NATO-s", etj. është gjuhë të cilën e hasim në shumë raste në praktikën e memorializimit si në memoriale ashtu edhe në fjalimet që mbahen gjatë eventeve të ndryshme përkujtimore. Pastaj gjuha e urrejtjes është një praktikë e zakonshme edhe në organizimet përkujtimore që ndërlidhen me luftën e fundit në Kosovë. Kjo lloj gjuhe kontribuon në ndërtimin e një kujtese kolektive të bazuar në urrejtje dhe, gjithashtu, në promovimin e përgjegjësisë kolektive.

4. PËRFUNDIME

- Memorializimi dhe rëndësia e tij në krijimin e kujtesës kolektive, e cila do të ndikonte në garantimin e mos-përsëritjes, nuk janë në fokus të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës;

- Proceset e memorializimit, të cilat janë nën organizimin dhe mbikëqyrjen e organeve shtetërore, karakterizohen me mungesë të një qasjeje gjithëpërfshirëse sa i

përket përkujtimit të ngjarjeve ku kanë pësuar individët nga të gjitha grupet etnike që jetojnë në Kosovë dhe në përkujtimin e të gjitha kategorive të viktimave;

- Shoqëria civile në Kosovë është duke luajtur një rol kyç në rritjen e ndërgjegjësimin drejt një qasjeje gjithëpërfshirëse në proceset e memorializimit;

- Në Kosovë mungon një ligj, i cili do të rregullonte standardet e memorialeve, duke përfshirë formën, vendin dhe madhësinë e tyre;

- Procesi i memorializimit në Kosovë vazhdon të karakterizohet me të dhëna të pasakta, gjuhë nacionaliste dhe të urrejtjes në baza etnike.

5. REKOMANDIME

- Institucionet shtetërore duhet të njohin rëndësinë e procesit të memorializimit në procesin e ballafaqimit me të kaluarën dhe të mbështesin një proces të tillë;

- Memorializimi në Kosovë duhet të mbështetet në një qasje gjithëpërfshirëse për të gjitha grupet etnike që jetojnë në Kosovë;

- Memorializimi në Kosovë duhet të përfshijë përkujtimin dhe nderimin e të gjitha kategorive të viktimave;

- Institucionet duhet të ndërmarrin hapa konkret në përpilimin e një ligji, i cili do të rregullonte standardet e ndërtimit të memorialeve.

- Memorialet duhet të ndërtohen me integritet, duke ofruar shërbim për qytetarët, informacion të saktë, pa gjuhë të urrejtjes dhe pa narrativa të njëanshme dhe përçarëse;

- Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës duhet:

- të përfshijë të gjitha memorialet në bazën e të dhënave,

- të ofrojë një shpjegim të shkurtër për çdo memorial që është në bazën e të dhënave të saj,

- të gjejë forma se si të përmirësohen memorialet që promovojnë gjuhën e urrejtjes dhe nacionalizmin dhe të ndaloj këtë praktikë për memorialet e ardhshme;

- Institucionet përkatëse në Kosovë duhet të themelojnë një muze të luftës, i cili duhet të themelohet me një qasje gjithëpërfshirëse dhe bazuar në fakte të sakta;

- Të mbijetuarit dhe përfaqësuesit e viktimave duhet të konsultohen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe në vazhdimësi lidhur me proceset e memorializimit;

- Në Kosovë duhet të promovohet më tepër praktika e përkujtimit grupor krahas praktikës së tanishme individuale.

6. SHËNJIMI I VENDEVE TË KRIMIT

Duke e konsideruar memorializimin si një mjet të rëndësishëm të drejtësisë tranzicionale në rolin e saj në ballafaqimin me të kaluarën, FDH Kosovë përgjatë dy viteve të fundit ka bërë një analizë se si është duke u zhvilluar një proces i tillë lidhur me ngjarjet e viteve 1998-1999 në Kosovë. Si rezultat i një analize të tillë, FDH Kosovë ka gjetur që procesi i memorializimit në Kosovë është kryesisht i përqendruar në memoriale statike si: buste, lapidare, komplekse memoriale, shtatore, pllaka përkujtimore dhe varreza të kategorive të ndryshme të viktimave. Në regjistrin e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale në Kosovë janë të listuara 1356 memoriale të tilla dhe shumica prej tyre ndërlidhen drejtpërdrejtë me luftën në Kosovë gjatë viteve 1998-1999. Nga numri i përgjithshëm, në tërë territorin e Kosovës janë të listuara 160 pllaka përkujtimore, 85 memoriale, 103 objekte të trashëgimisë të luftës së UÇK-së, 203 vende të rënies së dëshmorëve, 546 lapidare, 95 buste, 17 komplekse memoriale, 70 shtatore, 35 varreza të dëshmorëve, 17 varreza të dëshmorëve dhe martirëve dhe 25 varreza të martirëve. Përveç këtyre, ekziston edhe një grup i objekteve të ndryshme të memorialeve, të cilat janë jashtë këtij regjistri për arsye të përkujtimit të ngjarjeve që ndërlidhen me grupe të caktuara etnike.

Megjithëse kanë kaluar pak më shumë se dy dekada që nga përfundimi i luftës në Kosovë, një numër i madh i vendeve ku kanë ndodhur shkelje të rënda të të drejtave të njeriut janë zbehur nga kujtesa kolektive e shoqërisë. Një gjë e tillë është rezultat i mungesës së shënjimit të vendeve të krimit dhe, si pasojë e kësaj, kujtesa kolektive e shoqërisë lidhur me të kaluarën është e mangët. Duke pasur parasysh këtë, FDH Kosovë ka punuar në identifikimin e disa lokacioneve në tërë territorin e Kosovës ku kanë ndodhur shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe të njëjtat nuk janë shënuar akoma.

Shënjimi i vendeve të tilla të krimit është bërë përmes shkrimit të narrativave të shkurtra lidhur me lokacionet e caktuara ku ka pasur shkelje të rënda të të drejtave të njeriut përgjatë periudhës së luftës në Kosovë. Këto narrative janë plotësuar edhe me ilustrime figurative për të ofruar një qasje më afruese me lexuesit dhe janë ndërtuar duke u bazuar në faktet e vërtetuara nga institucionet e deritanishme gjyqësore kombëtare dhe ndërkombëtare, në intervistimin e dëshmitarëve dhe të mbijetuarve, në vizitat në hapësirat përkatëse, fotografitë dhe dokumente të ndryshme dokumentuese. Të tilla narrativa janë fokusuar në tri aspekte kyçe: për çfarë ka shërbyer më parë një hapësirë e caktuar, çfarë ka ndodhur aty gjatë luftës, dhe në çfarë është shndërruar ajo hapësirë tani. Procesi i identifikimit të vendeve të krimit dhe i përgatitjes së tregimeve se çfarë ka ndodhur në ato vende është përcjellë me sfida të shumta, siç janë mbledhja e dëshmive të bazuara, prania e narrativave kontraverze, hezitimi i dëshmitarëve për t'u intervistuar, ndryshimi i hapësirave, harresa e deri tek mohimi i ngjarjeve të caktuara, të cilat një pjesë e shoqërisë i konsideron të panevojshme për t'u përkujtuar dhe faktuar. Në kuadër të këtij procesi, FDH Kosovë ka përzgjedhur 12 vende të krimit, të cilat nuk janë të shënuara ende dhe të cilat nuk janë shumë të njohura për publikun në Kosovë. Përmes përgatitjes së narrativëve rreth ngjarjeve që kanë ndodhur në ato vende, FDH Kosovë synon të arrijë dy qëllime kyçe, së pari të përkujtojë viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut në ato vende, dhe, së dyti, të kontribuojë në pasurimin e kujtesës kolektive të shoqërisë si një pjesë mjaft e rëndësishme drejt arritjes së një paqeje të qëndrueshme.



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo


BUPRGU I SMPREKONICËS

VUSHTRRI

BURGU I SMREKONICËS

VUSHTRRI

Komuna e Vushtrrisë/Vučitrn është një nga zonat më të prekura nga lufta. Aty jetonin afro 90.000 banorë, rreth 90% ishin shqiptarë, ndërsa serbët ishin të vendosur kryesisht në qytetin e Vushtrrisë/Vučitrn dhe disa fshatra përreth. Aty, në periudhën 1998 – 2000 humbën jetën dhe/apo u zhdukën 576 persona si rezultat i luftës. Prej tyre, 506 shqiptarë, 56 serbë dhe 14 nga komunitetet joshumicë.



Ditën që nisën bombardimet e NATO-s, më 24 mars 1999, qyteti i Vushtrrisë/Vučitrn u granatua nga forcat serbe dhe mijëra shqiptarë u dëbuan nga shtëpitë. Shpërnguljet e dhunshme u intensifikuan nga fundi i muajit prill dhe si rezultat i kësaj, dhjetëra mijëra banorë u mbledhën në rajonin e Shalës deri kur filloi ofensiva e cila shpërndau turmën në dy drejtime: në drejtim të Podujevës/Podujevo dhe përgjatë lumit Sllakovc/Slakovc.



Nën përcjelljen e forcave të armatosura, një kolonë e 30.000 refugjatëve u nis në drejtim të qytetit të Vushtrrisë/Vučitrn. Me datën 2 maj 1999, në mbrëmje, kolona e njerëzve u ndalua mes fshatrave Studime e Epërme/ Gornje Studimlje dhe Studime e Poshtme/ Donje Studimlje sepse ishte ora e ndalim qarkullimit dhe vendosën ta kalojnë natën aty. Papritur, forcat serbe filluan të sulmonin nga të gjitha anët duke depërtuar në kolonën e civilëve dhe për orë të tëra i torturuan qytetarët që ishin të mbledhur aty. Mes plaçkitjeve dhe rrahjeve të rënda rreth 100 persona u vranë, e shumë tjerë u plagosën.



Pas mesnatës, u dha urdhër që kolona të lëvizte në drejtim të Vushtrrisë/Vučitrn. Të mbijetuarit vazhduan rrugën gjatë gjithë natës deri në mëngjesin e datës 3 maj duke lënë pas të afërmit e vranë dhe gjësendet e tyre. Nën mbikëqyrjen e policëve dhe disa ushtarëve, turma u drejtua në kooperativën bujqësore pranë motel Vicianum.



Pasi qëndruan për një kohë aty, policët filluan t'i ndanin burrat në një anë ndërsa të tjerët i urdhëruan të hipnin në traktorë e të vazhdonin për Shqipëri.



Ndërkohë që kolona me traktorë po largohej, pranë kooperativës erdhën dy kamionë me rimorkio, ku duke i goditur burrat e mbetur i detyruan të futeshin në kamionë dhe më pas i dërguan ata në burgun e Smrekonicës. Kamionët kishin bërë këtë rrugë disa herë, kështu duke transportuar qindra të burgosur.

Në oborr të burgut, pasi i mblodhën të dhënat personale, filluan t'i rrihnin dhe t'i shpërndanin burrat nëpër hapësira/objekte të ndryshme të burgut. Dhomat e burgut ishin të zbrazura, nuk kishte as shtretër, as mbulesa. Në dhomat e vogla futeshin dhjetëra e qindra njerëz, të cilët qëndruan pa ngrënë dhe pa pirë për tri ditë radhazi.




Pas tri dite të burgosurve u dhanë pak bukë dhe ujë, i cili dukej i kontaminuar pasi që shumë të burgosur u sëmurën. Burgu ishte i mbipopulluar, sepse kishte të burgosur që qëndronin edhe te salla e sporteve e edhe në korridore. Ata keqtrajtoheshin vazhdimisht dhe në grupe i dërgonin në oborrin e burgut apo afër sallës së televizionit dhe i rrihnin deri sa e humbnin vetëdijen. Pas disa dite, gjatë torturave, i merrnin në pyetje dhe ju dhanë një letër që ta nënshkruajnë, se ata akuzoheshin për terrorizëm. Përveç gardianëve të burgut dhe policisë së rregullt, të burgosurit kanë vërejtur edhe prezencën e Njësitit Special Anti-Terrorist.



Gjendja në të cilën ndodheshin të burgosurit u përkeqësua pas datës 16 maj 1999, kur në burg u sollën edhe 830 të burgosur tjerë nga Mitrovica. Atëherë të burgosurit mbaheshin edhe në banjo e bodrume derisa ata që ishin në dhoma, nuk kishin hapësirë as të shtriheshin në dyshtemenë e betonit.

Racionet e ushqimeve zvogëloheshin e shumë shpesh të burgosurit nuk kishin asgjë për të ngrënë. Rrahjet e keqtrajtimet ndodhnin në baza ditore, gardianët e burgut, si dhe policët kohë pas kohe ngarkonin dy kamionë me të burgosur dhe i dërgonin në shkollën e mesme të mjekësisë dhe në shkollën e mesme teknike të Mitrovicës. Aty i mbanin gjatë gjithë ditës, ku 'merreshin në pyetje' dhe keqtrajtoheshin dhe pastaj i kthenin në burg të Smrekonicës. Gjendja shëndetësore e të burgosurve ishte e rënduar. Nga të rrahurat e vazhdueshme ata pësuan lëndime serioze në kokë, në trup, si dhe gjymtyrë dhe dhëmbë të thyer. Nga deklaratat e dëshmitarëve, dihet se së paku një person është rrahur deri në vdekje ndërsa dy tjerë kanë ndërruar jetë më vonë si pasojë e keqtrajtimit në burg.





Në këto rrethana janë mbajtur rreth 3000 të burgosur, deri me datën 23 maj 1999. Në mëngjesin e 23 majit, të burgosurit u futën në autobusë dhe nën mbikëqyrjen e policëve u dërguan në Shtime nga ku u përcollën nga ushtria jugosllave deri në Zhur. Aty zbritën nga autobusët dhe ecën në këmbë deri te



kufiri dhe u detyruan të dorëzonin dokumentet e tyre të identifikimit që të kalonin në Shqipëri.

Krimet në burgun e Smrekonicës janë vërtetuar edhe nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë si dhe nga Gjykata Themelore në Mitrovicë në rastin kundër Zoran Vukotiqit. Ai është dënuar me burgim prej 6 vjet e 6 muaj për sjelljen çnjerëzore, në shkaktimin e vuajtjeve të mëdha me anë të zbatimit të torturës, rrahjes, cenimit të integritetit trupor dhe shëndetit të një numri të madh të civilëve shqiptarë, të paraburgosur në burgun e Smrekonicës.



BURGU I SMREKONICËS

ÇKA KA QENË?

Në vitin 1978 në fshatin Smrekonicë/Smrekovnica, afër fermës së pulave në hapësirë 18 ha. tokë është ndërtuar një paralele e burgut të Mitrovicës për të dënuarit e kthyer nga burgjet në Serbi (Pozharevc e Nish), pasi burgjet ekzistuese në Kosovë nuk kishin më kapacitet.


Më 1 janar të vitit 1981, në Smrekonicë/Smrekovnica filluan të vuajnë dënimet e tyre të gjithë ata persona për të cilët nuk kishte nevojë për masa të veçanta. Gjatë kësaj kohe, burgu në Smrekonicë kishte kapacitet për 180 të burgosur, kurse 1 vit më vonë ky institucion u shndërrua në Shtëpi Ndëshkuese Korrektuese, ku prante të dënuarit me 6 muaj deri në 1 vit nga e gjithë Kosova. Pas demonstratave të vitit 1981, numri i të burgosurve arriti në 700 edhe pse kushtet në objekte nuk përballonin këtë numër, në hapësira të ndryshme të objekteve (në fermë, në dhomë të pranimit, në ambulancë dhe në pavijone) u shtuan shtretër.

Me një vendim tjetër në vitin 1987 në këtë Shtëpi Korrektuese u pranuan edhe të gjithë meshkujt e dënuar për kundërvajtje si dhe të burgosurit politik. Nga viti 1980 – 1999 të burgosurit në Smrekonicë/Smrekovnica ishin mbi 70% shqiptarë. Gjatë mbajtjes së dënimit të burgosurit merreshin me bujqësi, blegtori si dhe punonin në hapjen e kanaleve.


BURGU I SMREKONICËS ÇKA ËSHTË SOT?

Që nga fundi i vitit 1999, Qendra Korrektuese në Smrekonicë/Smrekovnica është burg i tipit të hapur dhe ka kapacitet për 200 të dënuar për dënime deri në 3 vite. Objektet e Qendrës Korrektuese janë të njëjta vetëm se janë rinovuar. Të burgosurit në Smrekonicë/Smrekovnica janë të angazhuar në kultivimin e kulturave bujqësore.

Edhe pse ekzistojnë të dhëna të shumta mbi krimet dhe vuajtjet e shkaktuara në hapësirat e këtij burgu gjatë vitit 1998-1999, deri më sot nuk ka asnjë shënjim që tregon për ngjarjet e asaj kohe.



BURGU I SMREKONICËS HARTA





Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo

PRISHTINË


SÄN.LH.SI.SI.D I P.RI.SI.TI.NË.S

SPITALI I PRISHTINËS

PRISHTINË

Para luftës së fundit në Kosovë, komuna e Prishtinës/Priština kishte një popullsi prej 225,388 banorëve, ndërsa vetëm qyteti i Prishtinës/Priština kishte rreth 162,800 banorë, prej të cilëve rreth 80 përqind ishin shqiptarë. Në Prishtinë/Priština banonin edhe afro 20,775 serbë dhe 12,568 pjesëtarë të komuniteteve tjera.

Si pasojë e luftës përgjatë viteve 1998 – 2000, në këtë komunë humbën jetën dhe/apo u zhdukën 759 persona. Nga ta, 543 ishin shqiptarë, 189 serbë dhe 27 nga komunitetet tjera. Në qytetin e Prishtinës/Priština mbeten të vrarë dhe/apo të zhdukur 320 persona ndërsa fshatrat përreth që pësoan më së shumti janë Koliqi/Kolić, Makoci/Makovac, Grashtica/Graštica, Keqekolla/Kaçikol dhe Mareci/Marevce.



Prishtina/Priština si kryeqytet ishte qendër administrative e institucionale e Kosovës, ku ishin të vendosura të gjitha institucionet qendrore. Që nga viti 1970 Prishtina/Priština e kishte Universitetin e vet, si edhe Radio Televizionin e Prishtinës, si institucion publik.



Kur në vitin 1989 Kosovës ju hoq autonomia, diskriminimi ndaj shqiptarëve mori përmasa drastike. Universiteti dhe shkollat e mesme në gjuhën shqipe u mbyllën, shqiptarët u përjashtuan nga pozitat e tyre të punës në institucione publike dhe represioni policor u rrit. Pasojë serioze e këtyre masave ishte edhe largimi nga puna i shumë mjekëve dhe personelit shqiptarë në sistemin publik shëndetësor. Kjo i detyroi shqiptarët e Kosovës që, me vetë-financim t'i përgjigjen këtyre masave, duke krijuar institucione paralele në shëndetësi dhe arsim.




Gjatë viteve të 90-ta, shumë shqiptarë që kishin nevojë për shërbime shëndetësore jo-urgjente, u mjekuan në klinikat private të sistemit paralel të mbështetur nga ndihmat e shoqatës bamirëse Nënë Tereza. Megjithatë, një sistem i tillë nuk mund të zëvendësonte një program shtetëror të shëndetësisë, dhe kjo u reflektua me gjendjen shëndetësore të popullsisë, ku sipas raportit të Mjekëve për të Drejtat e Njeriut (PHR) , gjatë asaj kohe, vdekshmëria maternale dhe e fëmijëve shqiptarë ishte më e larta në Evropë.

Kjo gjendje tanimë e rënduar u përkeqësua edhe më shumë nga mesi i vitit 1998, kur nevoja për ndihmë mjekësore tejkaloi kapacitetet e klinikave private të sistemit paralel. Viktimat e luftës që sapo kishte filluar, dërgoheshin në Spitalin e Prishtinës për t'i trajtuar lëndimet trupore dhe plagët nga armët e zjarrit e mjetet shpërthyes.




Gjatë periudhës 1998 – 1999 u dokumentuan raste kur pacientët u abuzuan fizikisht, derisa më të rrezikuarit ishin personat që kishin ardhur nga zonat e konfliktit, të cilët ishin luftëtarë ose përkrahës të UÇK-së ose autoritetet serbe besonin se ishin të tillë. Ata lidheshin me pranga për shtrati edhe kur ishin pa vetëdije. Kishte raste kur keqtrajtoheshin e ju mohojë mjekimi. Spitali i Prishtinës ishte gjithnjë nën vëzhgimin e policisë dhe kjo i bënte të pasigurt pacientët shqiptarë dhe rriste rrezikun për keqtrajtim. Edhe mjekët shqiptarë ishin të frikësuar, dhe gjatë kësaj periudhe stafi mjekësor serb i shpërndanin e nuk i lejonin të rrinin bashkë më shumë se tre mjekë shqiptarë, me idenë se mos po bënin ndonjë komplot.



Në Spitalin e Prishtinës kishte qytetarë nga e gjithë Kosova me nevojë urgjente për intervenim. Në kaosin e krijuar aty, mohimi i dhënies së duhur të shërbimeve mjekësore nuk ishte shkelja e vetme që i bëhej pacientëve shqiptarë.

Pjesëtarët e UÇK-së kishin trajtimin më mizor në Spitalin e Prishtinës. Gjatë muajit korrik të vitit 1998 në Kirurgjinë Vaskulare ishte një dhomë ku gjendeshin 5 shqiptarë të hospitalizuar, tre ishin pjesëtarë të UÇK-së ndërsa dy ishin civilë. Të gjithë trajtoheshin si terroristë e edhe pse ishin të lidhur me pranga për shtrati ose radiatorë të dhomës, policët vazhdimisht u bënë roje. Gjatë qëndrimit të tyre në spital, torturat ishin të përditshme, ata nuk keqtrajtoheshin vetëm nga policët por edhe nga pacientët serbë që gjendeshin në spital. Atyre ju mohojë ndihma shëndetësore, i ushqenin pak dhe nuk ju ofronin mjaftueshëm ujë. E në anën tjetër, shpesh e linin ujin e pijshëm të rridhte në rubinet, si formë torture. Ata i rrihnin natën vonë, ua ekspozonin plagët dhe i goditnin me kondak të automatikut dhe i kërcënonin se do t'i vrisnin. Pas rreth një muaji ata lirohen nga spitali ku disa prej tyre dërgohen në burgje të ndryshme.

Kishte raste të keqtrajtimeve edhe tek pacientët që dyshohej se kishin lidhje familjare me ndonjë pjesëtar të UÇK-së. Një keqtrajtim i tillë i ndodhi edhe një vajzës civile 19 vjeçare. Ajo ishte e plagosur në pjesën e barkut nga forcat serbe në fshatin Pllaqicë/Pločica, dhe për shkak të nevojës për operim, u shtrua në Spitalin e Prishtinës në fund të muajit gusht të vitit 1998. Qysh në pranim ajo u keqtrajtua nga stafi mjekësor dhe policia, në bazë të dyshimit se ishte e afërme e një ushtari të UÇK-së. Ajo merrej në pyetje për përfshirjen e familjes së saj në luftë dhe policia ruante dhomën ku ajo ishte e shtrirë. Përveç keqtrajtimit fizik, asaj iu mohua edhe trajtimi i duhur mjekësor, me ç'rast nga plagët e marra ajo humbi jetën në spital më datë 05.09.1998.



Situata e përgjithshme në Kosovë reflektohej edhe në gjendjen e spitaleve. Nga 24 marsi i vitit 1999 kur filloi fushata ajrore e NATO-s, mjekët shqiptarë kishin dëgjuar se mund të mbaheshin peng nga serbët dhe kështu një numër i madh vendosën të mos shkonin më në punë. Njëjtë edhe lëvizjet e pacientëve ishin të diktuara nga lajmet ditore dhe kësisoji me fillimin e bombardimeve të gjithë pacientët që nuk kishin nevojë urgjente për shërbime mjekësore lëshuan spitalet. Kjo ndodhi edhe në Spitalin e Prishtinës, ku në mëngjesin e 25 marsit 1999, automjetet ushtarake ishin të parkuara në oborrin e spitalit, ndërsa ushtarët dhe policët serbë të armatosur patrullonin objektet e spitalit, e në kulm u vendosën snajperistët që vëzhgonin hyrjet dhe daljet.

Kjo gjendje shpërfaqte edhe më shumë shkeljen e neutralitetit mjekësor ku shumica e incidenteve në Spitalin e Prishtinës ndodhën pas muajit mars të vitit 1999.

Nga gjykimi i Nikola Šainović dhe të tjerët pranë TPNJ-s, vërtetohet se së paku një vajzë e re është dhunuar seksualisht në bodrumin e Spitalit të Prishtinës, në maj të vitit 1999. Gjatë sulmit të Ushtrisë Jugosllave dhe policisë në një fshat të Kosovës, me qëllim të dëbimit të qytetarëve kosovarë, ushtarët e morën vajzën e re bashkë me vëllain e saj, i cili ishte i plagosur, dhe i nisën për në Prishtinë/Priština.


Gjatë atij udhëtimi vajza u prangos, u mor në pyetje, u kërcënua, u rrah dhe u sulmua seksualisht nga njëri prej ushtarëve. Përdërisa po e shoqëronte vëllanë e saj të plagosur në Spitalin e Prishtinës, vajzën e morën dhe e dërguan në njërin nga bodrumet e spitalit, ku ishin edhe 10 deri në 15 gra të tjera, të gjitha shqiptare. Ajo më pas u rrah, u drogua dhe u dhunua nga tre ushtarë të Ushtrisë Jugosllave. Të nesërmen, ajo u kthye në dhomën ku po trajtohej vëllai i saj, dhe qëndroi aty deri në mes të qershorit 1999 kur të dy u larguan nga spitali. Për këtë rast dhunimi, paneli gjyqësor dënoi të pandehurit Nikola Šainović, Sreten Lukić dhe Nebojša Pavković.



SPITALI I PRISHTINËS

ÇKA KA QENË?

Qendra Klinike Spitalore ka filluar punën në dhjetor të vitit 1958. Pas themelimit të Fakultetit të Mjekësisë së Universitetit të Prishtinës, më 7 nëntor të vitit 1973, Fakulteti bashkohet me Spitalin e Prishtinës, si Organizatë e Punës së Bashkuar. Prej 29 dhjetorit 1977 deri më 1991, ka vepruar si Organizatë punuese e Fakultetit të Mjekësisë.



SPITALI I PRISHTINËS


ÇKA ËSHTË SOT?

Nga muaji qershor i vitit 1999, merr emrin Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK), pjesë e Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (SHSKUK). Përveç veprimtarisë shëndetësore, në QKUK ofrohet edhe veprimtaria arsimore dhe ajo kërkimore-shkencore. QKUK organizohet në klinika, institute, qendra, shërbime dhe njësi administrative.

Që nga lufta e deri më sot, edhe pse ekzistojnë të dhëna për abuzime masive të të drejtave të njeriut gjatë periudhës 1998-1999, në hapësirat e spitalit nuk ka asnjë shënim që tregon për ngjarjet e asaj kohe.

SPITALI I PRISHTINËS

HARTA





Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo

PODUJEVË


UPRA E ILUZHANIT

URA E LLUZHANIT

PODUJEVË

Para luftës qyteti i Podujevës/Podujevo ishte kryesisht i banuar nga shumica shqiptare, ndërsa rreth 2.8% ishin serbë dhe 1.4% i përkisnin komuniteteve të tjera jo-shumicë.

Në periudhën 1998 - 2000, në komunën e Podujevës/Podujevo janë vrarë dhe/apo zhdukur 519 persona, prej tyre 447 ishin shqiptarë, 376 ishin civilë ndërsa 71 ishin pjesëtarë të UÇK-së. Gjithashtu në këtë komunë humbën jetën dhe/apo u zhdukën 61 serbë, prej të cilëve 28 ishin civilë dhe 33 ishin nga formacionet e armatosura. Humbje pati edhe nga komunitetet tjera jo-shumicë, gjithsej humbën jetën 11 persona prej tyre 2 i përkisnin formacioneve të armatosura.



Gjatë vitit 1998, komuna e Podujevës/Podujevo u karakterizua me luftime të kohë pas kohshme midis forcave të armatosura serbe dhe UÇK-së. Më 15 shtator 1998 forcat serbe granatuan fshatin Dobratin/Dobrotin kështu duke i detyruar rreth 400 fshatarë të lëshonin shtëpitë e tyre. Ndërsa më 20 dhjetor 1998 forcat e mëdha ushtarake e policore arritën në Podujevë/Podujevo ku pati luftime edhe në Podujevë/Podujevo e edhe në fshatrat si Obrançë/O-branda, Gllamnik/Glamnik dhe Llapashticë e Poshtme/Donja Lapaštica.

Situata u tensionua edhe më shumë gjatë marsit të vitit 1999, sidomos në qytetin e Podujevës/Podujevo gjë që e detyroi popullsinë e mbetur të largoheshin për në Maqedoni apo të kërkonin strehim nëpër male.

Nga vendet që pësuan më së shumti gjatë viteve 1998 - 2000 ishte qyteti i Podujevës/Podujevo me rreth 100 persona të vdekur dhe/apo të zhdukur, pastaj fshatrat si: Lluzhan/Lužane, Dyz/Duz, Obrançë/Obrandë, Popovë/Popovo, Bradash/Bradaš, Pakashticë e Epërme/Gornja Pakaštica e kështu me radhë.



Më datë 1 maj të vitit 1999, rreth orës 12:00, mbi 40 persona po prisnin autobusin afër hotelit Besiana në një udhëkryq të Podujevës/Podujevo, mes dy rrugëve që njëra të dërgonte për në qytet e tjetra për në Prishtinë/Priština.



Rreth orës 12:30 aty kaloi autobusi i Nish Ekspresit që vinte nga drejtimi i Nishit, ku udhëtarë ishin persona në uniform. Autobusi nuk u ndal aty por vazhdoi në drejtim të Podujevës/Podujevo. Pas një kohe të shkurtër, i njëjti autobus u kthye gati i zbrazur dhe u ndal për t'i marr udhëtarët që po prisnin. Gjatë rrugës në drejtim të Prishtinës/Priština kur po kalonin mbi urën e Lluzhanit, një aeroplan i forcave të NATO-s goditi autobusin me një predhë.



Si pasojë e goditjes, aty humbën jetën 44 persona. Ndër ta ishin 31 civilë shqiptarë dhe 13 serbë prej të cilëve 7 civilë dhe 6 pjesëtarë të forcave serbe.


Autobusi nga goditja u nda në dy pjesë, ku një pjesë ra nga ura dhe pjesa tjetër mbeti e djegur aty mbi urë. Të mbijetuarit kishin pësuar djegie dhe lëndime të rënda trupore për të cilat u mjekuan në Spitalin e Prishtinës derisa njëri prej tyre nga plagët e marra, humbi dorën, njërin sy dhe më pas i amputuan edhe këmbën



Koloneli i NATO-s Konard Freytag, u deklarua se NATO e kishte marrë përgjegjësinë për sulmin, me arsyetimin se fatkeqësisht autobusi i cili në atë moment po kalonte mbi urë, nuk ishte parë nga piloti, pasi që vëmendja e tij kishte qenë e përqendruar në shënjestrën e tij, e që ishte ura.

Sipas gjetjeve të FDH dhe FDHK atë ditë në urën e Lluzhanit/Lužane
humbën jetën:


Shefqet Ajeti (1945), Kujtim Aliu (1968), Behxhet Bulliqi (1946),
Milovan Cvetić (1949), Božur Filipović (1948), Života Grujić (1964),
Miroslav Ilić (1961), Vladica Ivanović (1969), Ajeta Jakupi (1958),
Ibrahim Jakupi (1935), Miodrag Janković (1950), Vukosav Jelić (1950),
Gani Jupolli (1932), Mehmet Jusufi (1960), Arjeta Kopalla (1985),
Fatime Kopalla (1966), Fetije Kopalla (1953), Florinda Kopalla (1981),
Mirjeta Kopalla (1997), Xhavit Kopalla (1984), Bojan Kostić (1973),
Milana Malinić (1950), Drita Musa (1977), Fexhrije Musa (1970),
Selman Musa (1973), Marija Petrović (1984), Nikola Petrović (1982),
Smiljana Petrović (1933), Bexhet Podvorica (1960), Milazim Potera (1958),
Nuriye Potera (1967), Ibrahim Qerimi (1940), Besa Ramadani (1991),
Besarta Ramadani (1993), Besnik Ramadani (1983),
Bislim Ramadani (1996), Fatime Ramadani (1963), Gani Ramadani (1928),
Muzafer Ramadani (1986), Rizah Ramadani (1959),
Serbeze Rexhepi (1933), Halime Rrahmani (1964), Adem Uka (1947),
Zoran Vukadinović (1972).



URA E LLUZHANIT

ÇKA KA QENË?

Ura e Lluzhanit është ndërtuar në fund të viteve të 60-ta si urë lidhëse mes fshatit Lluzhan/Lužane dhe fshatit Shakovicë/Šakovica të Podujevës/Podujevo, mbi lumin Llap i cili buron në malet e Kopaonikut dhe rrjedhë përmes Podujevës/Podujevo. Ura është objekt i rëndësishëm sepse mbi të kalon arteria rrugore që lidh Prishtinën/Priština me rajonin e Podujevës/Podujevo e tutje me Serbinë. Pjesa e dëmtuar si pasojë e goditjes në vitin 1999 është rregulluar pas luftës.





URA E LLUZHANIT

ÇKA ËSHTE SOT?

Deri në vitin 2021 tek ura e Lluzhanit nuk ka pasur asnjë shënim për ngjarjen që ka ndodhur aty, përveç që janë vendosur kurora të luleve në urë. Megjithatë në përvjetorin e 22-të të ngjarjes tragjike, me datë 1 maj 2021 është përruruar pllaka përkujtimore kushtuar viktimave, e ngritur nga Komuna e Podujevës/Podujevo. Në pllakën përkujtimore janë shënuar emrat e 31 viktimave shqiptare dhe numri rendor 32, në vend të emrit të ndonjë viktime, përmbante tri pika. Kështu janë përjashtuar viktimat serbe që po ashtu humbën jetën në këtë ngjarje. Për më tepër, në pllakën përkujtimore nuk jipet asnjë shpjegim në lidhje me incidentin e ndodhur me datë 1 maj të vitit 1999. Kjo mënyrë e përkujtimit selektiv nuk kontribuon në tregimin e drejtë të ngjarjes si dhe diskriminon viktimat e nacionaliteteve të tjera. Edhe pas reagimit të FDHK-së, pllaka përkujtimore ka mbetur e njejtë, gjë që shpalos një narrativë të njëanshme. Të gjithë nismat për memoriale në nder të viktimave duhet t'i përfshijnë të gjitha viktimat, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre gjinore, raciale apo etnike, në mënyrë që të fuqizohen narrativat gjithpërfshirëse.

URA E LLUZHANIT

HARTA





Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo


XIHANILIA E KRUSSHES SË MADHE

RAHOVEC

XHAMIA E KRUSHËS SË MADHE

RAHOVEC

Komuna e Rahovecit/Orahovac është një nga rajonet më të prekura në Kosovë si pasojë e luftës gjatë viteve 1998-1999. Gjatë viteve të 90-ta aty jetonin rreth 60.000 banorë me një shumicë shqiptare mbi 90%. Në periudhën 1998-2000 në këtë komunë humbën jetën dhe/apo u zhdukën 950 persona. Prej tyre, 826 shqiptarë, 87 serbë, 23 ashkali, 9 romë, 3 malazez, 1 turk dhe 1 boshnjak.




Me fillimin e bombardimeve të NATO-s, sulmet dhe persekutimet e forcave serbe ndaj popullsisë shqiptare u intensifikuan dukshëm. Numri më i madh i masakrave ndodhi në këtë periudhë kur edhe filloi dëbimi i dhunshëm i popullsisë shqiptare për në Shqipëri. Pjesa e fshatrave të Rahovecit/Orahovac të cilat kufizohen me Komunën e Prizrenit ishin më të dëmtuarat, e në mesin e tyre fshati Krushë e Madhe/Velika Kruša u karakterizua me humbjet më të mëdha në njerëz, në të cilin ndodhi një nga masakrat më të mëdha të luftës në Kosovë.

Fshati Krushë e Madhe/Velika Kruša gjendet në një hapësirë gjeografike në mes të Komunës së Rahovecit/Orahovac dhe Komunës së Prizrenit. Para luftës së fundit në Kosovë, Krusha e Madhe/Velika Kruša kishte një popullsi me shumicë shqiptare prej rreth 2000 banorësh, e cila kryesisht merrej me bujqësi dhe blegtori. Ndërsa pjesa tjetër e popullsisë përbëhej nga ashkali – rreth 20 familje dhe serbë – rreth 4 familje.

Si pasojë e luftës në Kosovë, në këtë fshat humbën jetën dhe/apo u zhdukën 208 persona, nga të cilët 194 ishin shqiptarë dhe 14 ishin ashkali.

Menjëherë pas fillimit të intervenimit të NATO-s në Kosovë më 24 mars 1999, përgjatë 3 ditëve fshati Krushë e Madhe/Velika Kruša ishte nën rrethim të Ushtrisë Jugosllave, Policisë Serbe, grupeve paramilitare dhe gjithashtu në këtë rrethim ishin të përfshirë edhe individë të popullsisë civile serbe të Krushës së Madhe/Velika Kruša.

Në orët e para të mëngjesit të 25 marsit 1999 fshati u bombardua, dhe shtëpitë e banorëve u plaçkitën dhe u dogjën nga ushtria, policia dhe grupet paramilitare serbe. Si pasojë e këtyre ngjarjeve, popullsia fillimisht u zhvendos në malet përreth nga ku kishte mundësi të shikonte shtëpitë e tyre duke u plaçkitur dhe



djegur. Mbrëmjen e 25 marsit, një numër i madh i popullsisë u kthye në fshat dhe u fshehën në bodrumet e shtëpive ndërsa pjesa tjetër e popullsisë vazhdoi të qëndroi në malet përreth fshatit.



Ditën e 26 marsit forcat serbe, filluan të grumbullonin popullsinë civile nga vende të ndryshme ku ishin fshehur, goftë në shtëpitë e tyre apo në malet përreth. Burrat dhe djemtë u ndanë nga turmat e popullsisë dhe pastaj në lokacione të ndryshme u keqtrajtuat dhe më pas u ekzekutuan. Trupat e një pjese të madhe të tyre edhe u dogjën më vonë. Gratë, fëmijët dhe të moshuarit u detyruan të largoheshin për në Shqipëri nën britmën e trupave të armatosura serbe "Shkoni tek NATO". Por një pjesë e kësaj popullsie e përbërë nga gra dhe fëmijë u detyruan të shkonin në xhaminë e fshatit.



Xhamia në Krushë të Madhe/Velika Kruša gjendet në qendër të fshatit. Ajo u bombardua gjatë sulmeve serbe të 25 marsit 1999 me ç'rast u shkatërrua një pjesë e mureve të saj dhe pastaj e njëjta shërbeu edhe si vend ndalim i popullsisë civile nga forcat serbe. Në mëngjesin e 26 marsit 1999, në Lagjen e Nallve forcat serbe ndanë popullsinë civile në dy grupe: burrat u ndalën në atë lagje u plaçkitën dhe pastaj u ekzekutuan ndërsa gratë dhe fëmijët u mbyllën në xhaminë e fshatit.

Popullsisë civile në xhami, e përbërë nga gra dhe fëmijë, iu grabitën të gjitha gjësendet që posedonin me vete, si: stolitë, paratë dhe gjëra tjera me vlerë dhe sipas dëshmimeve të grave që ishin brenda aty si pasojë e këtyre plaçkitjeve u mbush një çantë e madhe me ari dhe para. Sipas dëshmitarëve, në xhaminë e fshatit ishte ushtruar edhe dhunë ndaj grave të cilat nuk kishin çfarë t'u jepnin forcave serbe apo në rastet kur nuk mund të hiqnin unazat nga gishtat e tyre dhe gjithashtu një numri të madh



të tyre i'u ishin shqyer veshët duke ia marrë vathët me dhunë.

Po ashtu, në raportin e OSBE-së "Kosovo as seen, as told", ceket se pjesëtarët e forcave të armatosura serbe nxorën me dhunë nga xhamia disa prej vajzave që gjendeshin aty dhe pastaj i kthyen më vonë.


Pas këtyre ngjarjeve, në orët e pasdites të 26 marsit të vitit 1999, popullsia civile e cila gjendej në xhami u lirua dhe u detyrua ta lëshoj fshatin për të marrë rrugë për në Shqipëri.

Krimet e kryera në Krushë të Madhe/Velika Kruša ceken në aktakuzën ndaj Slobodan Milosheviq dhe në aktakuzën ndaj Shainoviq dhe të tjerëve nga ish-Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi. Gykimi ndaj Slobodan Milosheviq mbeti në gjysmë për shkak të vdekjes së tij gjatë procesit gjyqësor. Ndërsa në gjykimin e Shainoviq dhe të tjerëve, trupi gjykues ka trajtuar vetëm pikën e aktakuzës lidhur me shkatërrimin e xhamisë si shkatërrim i pronës kulturore dhe e njëjta është hedhur poshtë për shkak të mungesës së provave të drejtpërdrejta për të vërtetuar se si është shkaktuar dëmi dhe nga kush. Deri më tani askush nuk është dënuar me një aktgjykim të formës përfundimtare lidhur me krimet e kryera në këtë fshat.



XHAMIA E KRUSHËS SË MADHE ÇKA KA QENË?

Xhamia në Krushë të Madhe/Velika Kruša është ndërtuar në vitin 1780 dhe rindërtuar prapë në vitin 1974. Ndërsa në marsin e vitit 1999, e njëjta u bombardua nga forcat serbe dhe pësoi dëmtime të mëdha. Që nga ndërtimi i saj, Xhamia në Krushë të Madhe/Velika Kruša ka shërbyer si vend për kryerjen e riteve fetare për popullsinë e besimit Islam të Krushës së Madhe/ Velika Kruša dhe të fshatrave përreth.



XHAMIA E KRUSHËS SË MADHE ÇKA ËSHTË SOT?

Pas përfundimit të luftës në Kosovë, Xhamia e Krushës së Madhe/Velika Kruša u renovua në vitin 2001 dhe u renovua prapë në vitin 2022. Xhamia e Krushës së Madhe/Velika Kruša është nën menaxhimin e Bashkësisë Islame të Kosovës dhe vazhdon të shërbej si një vend për kryerjen e riteve fetare për qytetaret e besimit islam. Dhe gjithashtu, tani është duke u ndërtuar edhe një aneks i saj i cili do të shërbej për organizimin e ceremonive mortore për banorët e fshatit.

Përkundër të dhënave dhe dëshmitarëve të gjallë të cilët kanë qenë viktimë të abuzimeve në objektin e Xhamisë së Krushës së Madhe/Velika Kruša gjatë luftës në Kosovë – në hapësirën e objektit të xhamisë nuk është vendosur asnjë shënim që tregon për ngjarjet e asaj kohe.

XHAMIA E KRUSHËS SË MADHE

HARTA





Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo


KOSOVË DHE SERBI

VAPREZAT MASIVE


VARREZAT MASIVE

KOSOVË DHE SERBI

Në periudhën janar 1998 – dhjetor 2000, si pasojë e luftës në Kosovë humbën jetën dhe/apo u zhdukën me dhunë 13.535 persona.




Nga ky numër 10.812 ishin shqiptarë (80%), 2.197 ishin serbë (16%) dhe 526 ishin boshnjakë, romë dhe pjesëtarë të tjerë nga grupet e minoriteteve (4%).



CIVILË 10.317

84% ■ 8.676 shqiptarë,
 11% ■ 1.196 serbë,
 5% ■ 445 boshnjakë, romë dhe pjesëtarë të tjerë nga grupet e minoriteteve



**PJESËTARËT E GRUPEVE
TË ARMATOSURA 3.218**

66% ■ 2.131 Ushtria Çlirimtare e Kosovës
 33% ■ 1.084 UJ, Policia dhe Paramilitarët
 1% ■ 3 NATO/KFOR

Nga ky numër, 10.317 ishin viktimë civile (nga të cilët 8.676 ishin shqiptarë, 1.196 serbë dhe 445 romë e të tjerë). Sa i përket viktimave nga grupet e armatosura – 2.131 ishin pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës; 1.084 ishin pjesëtarë të forcave ushtarake, paraushtarake dhe policore serbe dhe 3 pjesëtarë të Forcave të NATO-s në Kosovë – KFOR. Në periudhën 1998-2000, 1133 fëmijë u vranë dhe/apo u zhduken me dhunë dhe 109 prej tyre akoma rezultojnë të zhdukur. Pas qershorit të vitit 1999, në Kosovë rezultojnë rreth 6057 persona të zhdukur si pasojë e luftës dhe nga ky numër, fati i 1620 personave akoma nuk është zbardhur.

Menjëherë pas përfundimit të luftës, një numër i të zhdukurve u gjetën në burgje të ndryshme të Serbisë dhe numri më i madh i tyre u zbuluan në varreza masive brenda dhe jashtë Kosovës.




Pas fillimit të intervenimit të NATO-s në Kosovë, dhuna e forcave serbe u intensifikua dukshëm ndaj popullsisë civile në Kosovë. Kështu, për të fshehur krimet masive, autoritetet serbe filluan një fushatë të organizuar të zhvendosjes së trupave të viktimave nga territori i Kosovës në atë të Serbisë.




Që nga viti 2001 e deri më sot, 950 trupa të shqiptarëve të vrarë në Kosovë janë gjetur në 5 lokacione të varrezave masive brenda territorit të Serbisë. Në vitin 2001, u zbuluan 744 trupa në periferi të Beogradit në Batajnicë/Batajnica, në një parcelë e cila shërbente dhe vazhdon të shërbej si një qendër trajnimi për Njësitin Special Antiterrorist të policisë serbe. Pastaj në po të njëjtin vit, në Petrovo Sello/Petrovo Selo, në Serbinë Lindore u gjetën 61 trupa dhe po ashtu 84 trupa të tjerë u gjetën në liqenin Peruqac/Peručac në Serbinë Perëndimore. Në vitin 2013, në Rudnicë/Rudnica afër Rashkës/Raška në Serbinë Jugore afër kufirit me Kosovën u gjetën 52 trupa të tjerë të shqiptarëve. Dhe në vitet 2020-2021 u gjetën 9 trupa në Gurorën e Kizhevakut/Kiževak në Serbinë Jugore.

Trupat e 950 shqiptarëve të Kosovës u transportuan nga territori i Kosovës në këto 5 lokacione të ndryshme në Serbi me qëllim fshehjen e gjurmëve të krimeve dhe mbrojtjen e përgjegjësve nga përgjegjësia penale.

Në asnjërin nga 5 lokacionet e cekura me lartë, akoma nuk është vendosur ndonjë memorial i cili do të kontribuonte në shënjimin e këtyre vendeve të krimit dhe përfshirjen e tyre në kujtesën kolektive të shoqërisë. Lidhur me lokacionin e Batajnicës/Batajnica tash e disa vite ekziston një iniciativë nga organizatat jo-qeveritare Fondi për të Drejtën Humanitare dhe Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë e cila ka për qëllim themelimin e një qendre memoriale në vendin ku janë gjetur trupat dhe kështu të kontribuoj në pasurimin e kujtesës kolektive lidhur me ngjarjet që kanë ndodhur në atë lokacion gjatë vitit 1999.



Përveç praktikës së transportimit të trupave nga territori i Kosovës për në territorin e Serbisë, një numër i madh i varrezave masive u zbuluan edhe brenda për brenda territorit të Kosovës. Shumica prej tyre përfshinin viktimat të shqiptarëve si në Bellacerkë/Bela Crkva (77 trupa), varrezat në Dragodan (170 trupa), Pastasel/Pusta Selo (106 trupa), Brusnik (28 trupa), Rahovec/Orahovac (47 trupa), Bishtazhin/Bistražin (rreth 80 trupa), varrezat muslimane në Mitrovicën Veriore/Severna Mitrovica (76 trupa), etj. dhe një numër i tyre përmbante edhe trupa të serbëve si në Volljakë/Volujak (24 trupa), Malishevë/Mališevo (13 trupa) dhe Kleqkë/Klečka.



Por, ashtu si edhe në territorin e Serbisë, këto lokacione në Kosovë nuk janë të shënuara dhe në një formë janë vetëm pjesë e kujtesës së familjarëve të viktimave por jo edhe e kujtesës së gjerë kolektive. Përveç shënjimit të varrezave masive, në Kosovë mungon edhe një regjistër për numrin e përgjithshëm të varrezave masive, për numrin e tyre të saktë dhe për numrin e saktë të trupave që janë gjetur në të njëjtat.

Praktika e tillë e mos shënjimit të vendeve të krimit kontribuon në harresë dhe pamundëson krijimin e një kujtese kolektive lidhur me të kaluarën.

VARREZAT MASIVE

ÇKA KANË QENË?

Vende të cilat kanë shërbyer për funksione të ndryshme para fillimit të konfliktit të armatosur në Kosovë, u përdoren si vend për varreza masive për fshehjen e krimeve. Për të numëruar disa prej tyre, si rasti i varrezave masive në Batajnicë/Batajnica në të cilin vend ishte e vendosur një qendër trajnimi për Njësitin Special Antiterrorist të policisë serbe; Rasti i varrezës masive të Kizhevakut/Kiževak në të cilin vend ishte një gurore; Rasti i varrezës masive të Dragodanit në të cilin vend ishin varrezat civile të komunës së Prishtinës apo rasti i shpellës në fshatin Volljakë/Volujake në të cilën ishte fshehur një numër i trupave të serbëve të vrarë në kumunën e Rahovecit.





VARREZAT MASIVE

ÇKA JANË SOT?

Një numër i vendeve ku janë zbuluar varrezat masive vazhdojnë të kenë funksionin e njëjtë, si rasti i Qendrës së Trajnimit në Batajnicë/Batajnica apo varrezat e Dragodanit. Ndërsa një pjesë tjetër i është ndrruar funksioni, si rasti i Gurorës së Kizhevakut/ Kiževak e cila tashmë është privatizuar ose si rasti i Kampit Stërvitor në Petrovo Sello/Petrovo Selo i cili i përkiste Forcave Speciale të Policisë Serbe të cilat kanë vepruar në Kosovë gjatë luftës dhe tashmë është mbyllur. Shumë lokacione ku kanë qenë varrezat masive, pas ekshumimit kanë mbetur vende të braktisura, pa asnjë shenjë.

Për këto arsye dhe për shkak të mos shënjitimit të tyre, vendet e varrezave masive me kohë do të zbehen edhe nga kujtesa kolektive e shoqërisë.




LOKACIONET

Vendndodhjet e varrezave masive të identifikuara në Serbi:

1. Batajnicë/Batajnica: E zbuluar në vitin 2001. Në të janë gjetur 744 trupa të shqiptarëve të Kosovës.
2. Peruqac/Peručac: Trupat e shqiptarëve të Kosovës u shfaqën në sipërfaqe të liqenit më 1999. Më 2001, pranë liqenit është gjetur një varrezë masive me mbetjet mortore të 84 personave.
3. Rudnicë/Rudnica: Më 2013 u gjetën mbetjet mortore të 52 civilëve shqiptarë.
4. Petrovo Selo: E zbuluar në vitin 2001. Aty u gjetën 61 trupa të shqiptarëve të Kosovës.
5. Kizhevakut/Kiževak: Në vitet 2020-2021 u gjetën 9 mbetje mortore në guroren e Kizhevakut.


BARTJA E TRUPAVE NGA VENDET E KRIMIT NË KOSOVË TEK VARREZAT MASIVE NË SERBI



- NGA PEJA, VUSHTRRIA, FUSHË KOSOVA, SUHAREKA, MEJA DHE KORENICA NË BATAJNICË
- NGA MITROVICA, PRISHTINA, IZBICA DHE JANJEVA NË PETROVO SELO
- NGA DEÇANI DHE GJAKOVA NË PERUQAC



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo



FUSHË KOSOVË

STACIONI I AUTOBUSËVE


STACIONI I AUTOBUSËVE

FUSHË KOSOVË

Komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje gjendet në pjesën qendrore të Kosovës dhe i takon regjionit të Prishtinës/Priština. Ajo është qendër e komunikacionit ajror dhe hekurudhor në Kosovë, sepse në fshatin Sllatinë e Madhe/Velika Slatina, vendbanim në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, nga viti 1965 është hapur Aeroporti i Prishtinës e që sot quhet "Aeroporti Adem Jashari". Kjo zonë është zhvilluar si vendbanim pas vendosjes së stacionit hekurudhor i cili e lidh këtë qytet me qytetin e Prishtinës/Priština si dhe me qendrat tjera si Peja/Peć, Mitrovica dhe Shkupi në Maqedoninë e Veriut.

Deri në vitin 1998 në këtë komunë jetonin mbi 30.000 banorë, rreth 59 % ishin shqiptarë, 24 % serbë dhe 17 % nga komunitetet tjera. Vetëm në qytetin e Fushë Kosovës/Kosovo Polje kishte popullsi prej mbi 16,000 banorë prej të cilëve rreth 36 % ishin serbë, 27 % shqiptarë dhe 37 % nga komunitetet tjera jo-shumicë.

Si pasojë e luftës në Kosovë, në territorin e kësaj komune përgjatë viteve 1998-2000 humbën jetën 173 viktime, prej të cilëve 130 ishin shqiptarë, 35 serbë dhe 8 nga komunitetet jo-shumicë. Vetëm në qytetin e Fushë Kosovës/Kosovo Polje si rezultat i luftës u vranë dhe/apo u zhdukën 78 viktime, ndërsa ndër ngjarjet tragjike aty njihet rasti i familjes Mirena në fshatin Nakaradë/Nakarade ku u vranë 16 anëtarë të kësaj familje.



■ 130 shqiptarë,
■ 35 serbë,
■ 8 komunitetet jo-shumicë

173 TOTAL



Vrasjet dhe zhdukjet e njerëzve filluan të ndodhnin në Fushë Kosovë/Kosovo Polje qysh në qershor të vitit 1998. Situata u përkeqësua pothuajse menjëherë pas tërheqjes së Misionit Vëzhgues të OSBE-së nga Kosova, më 20 mars 1999. Atëherë u shpeshtuan edhe më shumë maltretimet, plaçkitjet, dëbimet me forcë dhe vrasjet dhe një numër i madh i banorëve të Fushë Kosovës/Kosovo Polje u dëbuan nga qyteti. Ata u detyruan të nisen për në Maqedoni ose Shqipëri. Stacioni hekurudhor në Fushë Kosovë/Kosovo Polje ka qenë vendi nga ku më së shumti shqiptarë u larguan me tren në drejtim të Maqedonisë.



Megjithatë, stacioni hekurudhor nuk ishte vendi i vetëm në qytetin e Fushë Kosovës/Kosovo Polje ku kishte shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Stacioni i autobusëve është në të njëjtin objekt me stacionin hekurudhor. Ky vend gjatë luftës gjithashtu ishte përdorur nga forcat ushtarake dhe paramilitare serbe për të ndaluar popullsinë shqiptare dhe për t'i maltretuar dhe keqtrajtuar ata.



Një rast i tillë ka ndodhur në stacionin e autobusëve me datë 26 mars të vitit 1999. Në mëngjesin e ditës së premte, përafërsisht rreth orës 11:00, në stacionin e autobusëve në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, ishin mbledhur për të pritur autobusin mbi 100 civilë shqiptarë, burra, gra dhe fëmijë, pasi që përpiqeshin të largoheshin nga Fushë Kosova/Kosovo Polje për në Prishtinë/Priština për arsye sigurie. Pas një kohe në atë vend arriti një grup i përbërë nga më së paku dhjetë pjesëtarë të forcave të ndryshme serbe me një automjet ushtarak, ku disa nga ta ishin të maskuar.



Grupi i armatosur i forcave serbe i ndaloi civilët duke mos i lejuar që të hipnin në autobus ose të largohen nga stacioni, ndërsa ata që veçse ishin në autobus i detyruan të zbrisnin. Pas grumbullimit të tyre, ata i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët, duke i shtyrë me tytat e armëve dhe mbanin kontrollin nën kërcënimin e armëve. Sipas dëshmitarëve okularë, të cilët kanë qenë në vendin e ngjarjes dhe të cilët kanë dëshmuar edhe në dy proceset gjyqësore lidhur me këtë ngjarje, gratë dhe fëmijët janë detyruar që të kthehen me shpinë për të mos parë maltretimet që po i bëheshin burrave. Fillimisht burrat u detyruan të gjunjëzoheshin me duart prapa kokës dhe të këndonin këngë nacionaliste serbe, e më pas i rrahën me shkopinj gome dhe druri. Njëri prej dëshmitarëve dëshmoi se një pjesëtarë i këtij grupi e kishte marrë patericën e një personi të moshuar dhe i godiste me të burrat derisa ajo ishte thyer.



Gjatë asaj dite, u rrëmbyen me forcë dy meshkuj, civilë shqiptarë, ku njëri nga ta më pas u lirua ndërsa tjetri, Haki Bajrami, nuk është parë më qysh nga dita kritike dhe u konsiderua i zhdukur. Por më vonë trupi i tij është gjetur në një

varrezë masive në lagjen


Dragodan, në Prishtinë,

kurse mbetjet e tij janë identifikuar në vitin 2000.

Nga maltretimet e shumta të asaj dite, njëri prej personave që kishte pësuar atë ditë, e që në atë kohë kishte qenë 70 vjeçar, dëshmoi se asnjë herë nuk kishte arritur që të shërohej plotësisht nga plagët e marra. Në lidhje me këtë rast janë zhvilluar

dy procese gjyqësore në Kosovë, me ç'rast Ivan

Radivojeviq si ish-pjesëtarë i policisë rezervë serbe dhe Skender Bislimi si ish-pjesëtarë i forcave paramilitare serbe janë dënuar për krime lufte kundër popullsisë civile. Gjykata ka gjetur se të pandehurit kishin shkaktuar frikë dhe terror, kishin cenuar integritetin trupor dhe shëndetin e së paku 40 burrave civilë shqiptarë. Për këtë arsye Ivan Radivojeviq është dënuar me 6 vite burgim, ndërsa Skender Bislimi është dënuar me 10 vite burgim.



STACIONI I AUTOBUSËVE

ÇKA KA QENË?

Stacioni hekurudhor i Fushë Kosovës/Kosovo Polje është ndërtuar gjatë viteve 1870–1874. Shumë më vonë, pas Luftës së Dytë Botërore, hapësira përpara këtij stacioni ka filluar të shfrytëzohet edhe si pikënisje dhe vendndalim i autobusëve që shkonin në relacionin Prishtinë-Fushë Kosovë.





STACIONI I AUTOBUSËVE


ÇKA ËSHTË SOT?

Edhe sot shfrytëzohet e njëjta hapësirë për stacionin e autobusëve në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, ashtu siç ka qenë më parë.

Në këtë stacion mungon shënimi i ngjarjeve të vitit 1999. Përkundër faktit se ka informacione të bollshme në lidhje me to dhe faktit se për ngjarjet në stacionin e autobusëve në Fushë Kosovë/Kosovo Polje ka pasur mjaft dëshmitarë të cilët kanë dhënë dëshmitë e tyre në procedura gjyqësore dhe janë nxjerrë vendime të plotfuqishme, ky vend akoma nuk është shënuar si vend i krimit. Në rastin që ky vend do të shënohej në të ardhmen, do t'i kontribuonte pasurimit të kujtesës kolektive dhe informimit të qytetarëve në lidhje me ngjarjet të cilat kanë ndodhur në stacionin e autobusëve në Fushë Kosovë/Kosovo Polje.

STACIONI I AUTOBUSËVE

HARTA





Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo



ENISHTË SHKËMBI KUFIRI

VËRMICË

KUFIRI ME SHQIPËRINË

VËRMICË, PRIZREN

Gjatë luftës në vitet 1998-1999, dëbimi i popullsisë shqiptare nga territori i Kosovës u organizua me një plan të veçantë përmes përdorimit të dhunës, masave të frikësimit dhe krijimit të një ambienti të pasigurt për të jetuar. Largimi me dhunë i popullatës shqiptare nga Kosova është kryer me një shkallë të koordinimit dhe kontrollit që e bën të pamundur arritjen e ndonjë përfundimi tjetër përveç dëbimit sistematik të detyruar. Një përfundim i tillë është vërtetuar edhe nga gjykimi i Sainoviq dhe të tjerëve me rastin e vërtetimit të pikës së aktakuzës ku ceket se "Forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, në mënyrë sistematike, kanë dëbuar dhe zhvendosur me forcë qindra mijëra shqiptarë të Kosovës nga shtëpitë e tyre në mbarë krahinën e Kosovës. Për të lehtësuar këto dëbime dhe zhvendosje, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë kanë krijuar qëllimisht një atmosferë frike dhe shtypjeje përmes përdorimit të forcës, kërcënimeve me forcë dhe akteve të dhunës".

Largimi i popullsisë shqiptarë nga Kosova kishte nisur që në fillim të viteve të 90-ta, si pasojë e masave të dhunshme, largimit nga puna dhe masave diskriminuese në edukim, shëndetësi dhe të drejtat e tjera themelore. Pastaj më fillimin e konfliktit të armatosur filloi dëbimi me dhunë nga shtëpitë e tyre dhe u intensifikua dukshëm pas fillimit të intervenimit të NATO-s në ish-Jugosllavi.


Sipas raportit të UNHCR, "Krizë e refugjatëve në Kosovë, një vlerësim i pavarur i gatishmërisë dhe reagimit emergjent të UNHCR-së", mbi 1 milion qytetar të Kosovës ishin dëbuar nga vendi dhe vetëm gjatë 9 javëve të para pas fillimit të intervenimit të NATO-s më shumë se 860.000 qytetar ishin strehuar në shtetet e rajonit. Nga të cilët 444.600 u strehuan në Shqipëri, 344.500 në Maqedoni dhe 69,900 në Malin e Zi.

Gjatë kësaj periudhe, dëbimi arriti në atë nivel sa që forcat e armatosura serbe shkonin shtëpi më shtëpi në vendbanimet e ndryshme dhe dëbonin më dhunë banorët nga shtëpitë e tyre duke i urdhëruar që të lëshonin Kosovën. Popullsia u urdhërua që të lëshoj Kosovën në drejtim të shteteve të ndryshme përmes pikave të ndryshme kufitare. Zakonisht popullsia e dëbuar u drejtua në kufijtë



me të afërt. Shumica e popullsisë nga gjysma perëndimore e Kosovës u drejtua në kufirin jugperëndimor me Shqipërinë ndërsa gjysma lindore u drejtua në kufirin juglindor për në Maqedoni. Në anën tjetër, banorët e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica, Vushtrrisë/Vučitrn dhe zonave të tjera me popullsi shqiptare në veri të Kosovës u dërguan përgjithësisht në kufirin me Shqipërinë. Një pjesë e madhe e banorëve të Pejës/Pec dhe Istogut/Istok kaluan në Mal të Zi, ndërsa një numër i banorëve nga komunat më lindore të Kosovës hynë fillimisht në Serbinë jugore dhe pastaj kaluan kufirin për në Maqedoni. Por pati edhe zona të cilat u karakterizuan me largime me të vogla të popullsisë, si rajoni i Drenicës në Kosovën qendrore nga i cili pak banorë u larguan nga Kosova, përveç banorëve të dëbuar nga qyteti i Glogocit/Glogovac në fillim të Majit 1999.

Shumica e popullsisë u largua përmes mjeteve të tyre të transportit si me vetura, traktor apo qerre por edhe në këmbë. Por një numër relativisht i madh u larguan edhe përmes transportit të organizuar nga forcat serbe duke bërë grumbullimin e popullsisë në pika të caktuara dhe pastaj përmes autobusëve dhe mjeteve ushtarake të transportit bënë transportin e popullsisë deri në kufijtë e caktuar. Pastrimi etnik i Qytetit të Pejës/Pec gjatë ditëve 24-29 Mars 1999 është një shembull konkret i organizimit të transportit për dëbimin e popullsisë. Gjatë kësaj periudhe, banoret shqiptarë të të gjitha lagjeve të Pejës/Pec u detyruan të lëshojnë shtëpitë e tyre dhe të mbledhen në pikat grumbulluese në qendër të qytetit. Pastaj, policia serbe organizoi autobusë për të transportuar banoret drejt Prizrenit/Prizren dhe pastaj drejt Shqipërisë. Me 29 Mars, pothuajse të gjithë banorët shqiptarë ishin dëbuar me forcë nga qyteti i Pejës/Pec.



Siç u theksua edhe më lartë, kufiri më Shqipërinë ishte më i ngarkuari me refugjatë të cilët po lëshonin territorin e Kosovës dhe shumica e qytetarëve të dëbuar nga shtëpitë e tyre, afër gjysmë milioni, kaluan në Shqipëri përmes pikës kufitare në Vërmicë/Vermica. Vetëm gjatë ditëve 27-29 Mars 1999, rreth 64.000 refugjatë kaluan në Shqipëri përmes kësaj pike kufitare duke arritur deri në 28.000 refugjatë në baza ditore. Ndërsa kolona e refugjatëve në shumë raste arriti gjatësi deri në 15 km në pjesën kufitare të Kosovës.



Grupet e popullsisë të cilat po largoheshin nga Kosova, që nga shtëpitë e tyre e deri në kalimin e pikave kufitare iu nënshtruan maltretimeve të vazhdueshme nga forcat serbe, plaçkitjeve, fyerjeve të simboleve kulturoro-kombëtare e në shumë raste shume persona edhe u ekzekutuan. Dhuna dhe maltretimi shkuan deri në atë masë sa që shumë personave iu kërkuan shuma të caktuara parash në këmbim të jetës së tyre dhe të familjarëve të tyre.


Qindra refugjatë që u dëbuan për në Shqipëri treguan se para se të lejoheshin të kalonin kufirin u detyruan të dorëzonin pasaportat, kartat e identitetit, patentë shoferët, librezat e automjeteve dhe certifikatat e lindjes të cilat shpesh u grisehin para tyre. Në anën tjetër, atyre që kalonin kufirin me makinë, iu dhanë kaçavida dhe u urdhëruan të hiqnin targat nga automjetet e tyre. Por një praktikë krejt tjetër u përdor për refugjatët që u dëbuan për në shtetet tjera të rajonit si në Maqedoni dhe Mal të Zi, të cilët përgjithësisht u lejuan të mbanin dokumentet e tyre, edhe pasi të kontrolloheshin ato nga oficerët e policisë serbe.



Një praktikë e tillë e konfiskimit të dokumenteve të identifikimit u përdor për të arritur qëllimin e zhveshjes së të dëbuarve nga shtetësia e ish RFJ-së dhe në këtë mënyrë moslejimin e kthimit të tyre në Kosovë pastaj. Kështu procedurat kufitare u përdoren si mjete plotësuese për pastrimin etnik të territorit të Kosovës. Konfiskimi i gjerë i dokumenteve të identitetit dhe targave të makinave nga policia serbe dhe rojet kufitare tregon gjithashtu natyrën sistematike të dëbimeve.

KUFIRI ME SHQIPËRINË ÇKA KA QENË?


Pika Kufitare në Vërmicë/Vermica ka qenë një nga lidhjet kryesore që ka lidhur shtetin Shqiptar me Krahinën Socialiste Autonome të Kosovës të ish Jugosllavisë. Gjatë viteve 1945 – 1990 si pasojë e politikave të pushtetit komunist në Shqipëri kjo pikë kufitare ka qenë e mbyllur. E njëjta është hapur prapë në vitin 1991 pas rënies së pushtetit komunist në Shqipëri.



KUFIRI ME SHQIPËRINË ÇKA ËSHTË SOT?


Pika kufitare në Vërmicë/Vermica është një ndër vendkalimet kufitare të zyrtarizuara ndërkombëtare të Kosovës dhe që shërben si lidhje ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Në këtë vendkalim kufitar kryhet qarkullimi i udhëtarëve, mallrave, mjeteve transportuese, veturave, si dhe zhdoganimi e kontrollimi i mallrave dhe i udhëtarëve. Vendkalimi kufitar në Vërmicë/Vermica me pozitën e vetë gjeografike është i vetmi vendkalim kufitar, që shërben për qarkullimin e mallrave komerciale dhe është pika me qarkullimin më të madh të qytetarëve, të cilët shkojnë apo vijnë nga Shqipëria.

Pavarësisht fakteve që përmes kësaj pike kufitare kaluan qindra mijëra refugjatë nga Kosova për në Shqipëri si pasojë e luftës në Kosovë dhe maltretimeve të shumta që të njëjtëve iu janë bërë në kufi, në këtë vend nuk është vendosur asnjë shënim si memorializim për këto ngjarje i cili do të kontribuonte në pasurimin e kujtesës kolektive të shoqërisë Kosovare.



KUFIRI ME SHQIPËRINË

HARTA





Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo

VUSHTRRI


SHITËPIJA AFËR VAPRIZAVE

SHTËPIA AFËR VARREZAVE

VUSHTRRI

Vushtrria/Vučitrn është një ndër qytetet më të lashta të Kosovës, e që sipas regjistrimit të popullsisë para luftës, kishte pasur 65,671 banorë, me strukturë të përzier etnike, e që rreth 90% i takonin etnisë shqiptare. Ndërsa sipas regjistrimit të popullsisë të kryer në vitin 2011, numri i banorëve të Komunës së Vushtrrisë/Vučitrn ishte 69,870 banorë.

Me datë 24 mars 1999 kishte filluar Operacioni Ushtarak i NATO-s kundër Republikës Federale të Jugosllavisë, me ç'rast edhe është shpallur zyrtarisht gjendje lufte në tërë territorin e Kosovës. Nga kjo datë në tërë territorin e Kosovës, e gjithashtu edhe në Vushtrri/Vučitrn u kryen krime të tmerrshme, e ku ndër këto krime ishin kryer edhe dhunime seksuale.



Gjatë luftës në Vushtrri/Vučitrn dhe rrethinat e saj janë vrarë dhe/apo zhdukur 576 persona si rezultat i luftës, prej tyre 506 shqiptarë, 56 serbë dhe 14 nga komunitetet pakicë.



Me datën 22 maj të vitit 1999, forcat ushtarake, policore dhe paramilitare serbe, pasi që i kishin plaçkitur, e dëbuan popullsinë civile shqiptare nga shtëpitë e tyre dhe i tubuan afër varrezave të qytetit të Vushtrrisë/Vučitrn ku i detyruan që të ulen në tokë. Gjatë kohës që civilët qëndruan në atë pozitë, ata i'u nënshtruan rrahjes me një shkop të drurit, duke u goditur në kokë dhe në pjesë të ndryshme të trupit nga disa pjesëtarë të forcave policore e ushtarake të Serbisë.




Më pas disa nga meshkujt i ndanë nga turma, i detyruan të hipnin në disa kamionë dhe i larguan nga vendi në drejtime të ndryshme, disa prej tyre drejt burgut të Smrekonicës/Smrekovnica, e të tjerët drejt sallës së sporteve të Vushtrrisë/Vučitrn. Pjesa tjetër e civilëve të mbetur në atë vend ishin pleq, gra dhe fëmijë dhe të njejtit i rreshtuan dhe i detyruan që të ecnin drejt një shtëpie dy katëshe, për t'i regjistruar dhe pajisur me kartela të identifikimit.




Në këtë rresht të personave të cilët ishin renditur për të pritur kartelat e tyre të identifikimit, ishte edhe një grua (për shkak të anonimitetit të saj, në vazhdim do t'i referohemi si gruaja), e cila në atë kohë kishte qenë në muajin e tretë të shtatëzanisë, duke pritur binjakë. Ajo në rresht ishte së bashku me nënën, motrën, vjehrrën dhe dy vajzat e saj, njëra prej të cilave në atë kohë ishte 9 muajshe, të cilën gruaja po e mbante në krah, ndërsa tjetra ishte 3 vjeçe.

Nga ai rresht, gruaja u nxorr nga një pjesëtar i forcave policore serbe, i cili vajzën e vogël të cilën gruaja e mbante në krah, ia mori nga duart dhe e përplasi në tokë. Në këtë moment vjehrra e saj kishte reaguar, por si pasojë e reagimit të saj mori një goditje në ballë me kondak të pushkës automatike, me ç'rast iu gjakos koka, e më pas ai tërhoqi gruan dhe me dhunë e futi në shtëpinë pranë të cilës po qëndronin të rreshtuar.

Ai e dërgoi gruan në një rën nga dhomat në katin e dytë të shtëpisë, ku kishte edhe gra të tjera të zhveshura dhe të dhunuara nga disa policë serbë. Ai e përplasi gruan përtokë, ia shqeu rrobat me forcë dhe e dhunoi, duke u ndihmuar edhe nga një polic tjetër.



Pas dhimbjeve të cilat gruaja po i përjetonte, ajo kishte të vjella dhe ishte kthyer anash me trup për të vjellë, në atë moment u godit me shqelm në kurriz, e që si pasojë gruaja humbi vetëdijen. Pasi që i ishte kthyer vetëdija gruaja e pa veten në dhomë të zhveshur dhe njëri nga policët i cili ishte aty, e kapi për krahu dhe me dhunë e largoi nga aty duke i thënë "ik".



Një krim i tillë ndikoi jashtë mase negativisht në jetën e gruas, pasi që ajo ka pësuar trauma të mëdha fizike dhe psikologjike, e që mbi të gjitha ajo humbi foshnjat e saj ende të palindura, si rezultat i një aborti të cilin e pësoi gjatë muajit shtator të atij viti.



Gruaja pasojat e këtij krimi të kryer ndaj saj i vuan ende sot, e cila përkundër trajtimit të vazhdueshëm ende nuk e ka kaluar ç'rregullimin e stresit postraumatik.

Për këtë rast është zhvilluar edhe një proces gjyqësor nga Gjykata Themelore në Prishtinë, me ç'rast i akuzuari Zoran Vukotiq, ish pjesëtar i forcave rezervë të policisë serbe, në vitin 2021 është shpallur fajtor për veprën penale "Krime të luftës kundër popullsisë civile" dhe është dënuar në kohëzgjatje prej 10 vite burgim, aktgjykim ky i cili nuk e ka marrë formën e prerë.

Gjatë ditës së njejtë, janë kryer edhe një numër i madh i krimeve të tjera, sidomos në shtëpitë e familjes Pasoma dhe Cakaj, ku edhe janë masakruar 72 civilë, përfshirë aty burra, gra dhe fëmijë, të cilët janë maltretuar dhe vrarë në mënyrë mizore. Distanca nga shtëpia në të cilën është kryer dhunimi/et, me shtëpinë e familjes Cakaj është vetëm 15 metra, ndërsa distanca nga shtëpia e familjes Pasoma përafërsisht 100 metra në vijë ajrore.

SHTËPIA AFËR VARREZAVE

ÇKA KA QENË?

Shtëpia në të cilën ka ndodhur ngjarja ka qenë shtëpi e dy vëllezërve civilë shqiptarë, të cilët e kishin ndërtuar shtëpinë në vitin 1981/1982. Ajo ishte shtëpi e ndarë në dy hyrje, për të dy vëllezërit dhe familjet e tyre, me dy kate dhe nënkulm. Pranë kësaj shtëpie ishin edhe 4 shtëpi tjera, të gjitha të familjarëve të tyre, në të cilat gjatë kohës së luftës kanë strehuar rreth 81 persona.

Gjatë ditës kritike të 22 majit, shtëpia e vëllezërve ishte përdorur nga policia, ushtria dhe paramilitarët serb, ku edhe brenda saj ishin kryer një numër i madh i krimeve.

Kjo shtëpi së bashku me 3 shtëpi të familjarëve të tyre dhe të shumë komshinjëve afër tyre, në të njejtën ditë, më 22 maj, ishin djegur në tërësi.



SHTËPIA AFËR VARREZAVE

ÇKA ËSHTË SOT?

Shtëpia, rreth dy vite pas përfundimit të luftës është rindërtuar nga pronarët dhe është sjellë në gjendjen e njejtë siç ka qenë më parë, ku edhe kishin jetuar deri në vitin 2013. Më pas shtëpia është blerë nga një pronar tjetër, i cili e ka ristrukturuar në tërësi dhe jeton aty edhe sot.

Përkundër faktit se në këtë shtëpi janë kryer krime të rënda lufte, aty nuk është ngritur asnjë memorial apo ndonjë pllakë e cila do ta shenjzonte këtë shtëpi si vend në të cilin janë kryer krimet.

SHTËPIA AFËR VARREZAVE HARTA



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo



RAHOVEC


E ASHTUQUAJTURA
'GROP'A PËR BËRILIG'

E ASHTUQUAJTURA 'GROPA PËR BËRLLOG'

RAHOVEC


Komuna e Rahovecit/Orahovac është një nga rajonet më të prekura në Kosovë si pasojë e luftës gjatë viteve 1998-1999. Gjatë viteve të 90-ta aty jetonin rreth 60.000 banorë me një shumicë shqiptare mbi 90%. Në periudhën 1998-2000 në këtë komunë humben jetën dhe/apo u zhduken 950 persona. Prej tyre, 826 shqiptarë, 87 serbë, 23 ashkali, 9 romë, 3 malazezë, 1 turk dhe 1 boshnjak.

1998-2000



Komuna e Rahovecit/Orahovac u karakterizua me numër të madh të viktimave edhe gjatë vitit 1998. Gjatë këtij viti në këtë komunë u vranë dhe/apo u zhduken 240 persona. Prej të cilëve, 183 shqiptarë, 52 serbë, 4 romë dhe 1 malazezë.


1998



- 183 shqiptarë,
- 52 serbë,
- 5 nga komunitetet pakicë

240 TOTAL

Numri më i madh i viktimave ishin civilë të pa-armatosur, përkatësisht 186 civilë, të cilët u ekzekutuan në vende dhe rrethana të ndryshme dhe pastaj trupat e tyre u varrosën në lokacione të ndryshme qoftë nga familjarët e tyre kur kjo ishte e mundur apo nga institucionet përkatëse komunale të asaj kohe. Numri më i madh i viktimave që u varrosën nga strukturat komunale, u varrosën në të ashtuquajturën "Gropën për Bërlllog".





Gropa për Bërlllog gjendej menjëherë prapa varrezave myslimane të qytetit të Rahovecit/Orahovac dhe ishte një hapësirë në të cilën hidheshin mbeturina të ndryshme për një kohë të gjatë dhe ishte shndërruar në një deponi ilegale të mbeturinave. Gjatë vitit 1998, trupa të shqiptarëve të cilët u ekzekutuan nga forcat serbe u varrosën në këtë hapësirë.

Më 17 korrik 1998, forcat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës hynë në Rahovec/Orahovac dhe filluan luftimet në mes tyre dhe forcave të armatosura serbe. Në mbrëmjen e 18 korrikut 1998, forcat e policisë speciale serbe të stacionit të Prizrenit arritën në qytetin e Rahovecit/Orahovac. Të nesërmen me 19 korrik, herët në mëngjes, forcat speciale policore filluan të hyjnë në shtëpitë e banorëve shqiptarë – i bastisnin, kërkonin armë, shtënin në të gjitha anët, i hidhnin bomba dore në bodrume, plaçkitnin dhe i vënin zjarrin shtëpive. Në anën tjetër, pjesëtarët e Brigadës 549 të Motorizuar e bombarduan qytetin nga drejtimi i fshatrave Landovicë/Landovica dhe Rogovë/Rogovo.



Ky aksion i policisë speciale zgjati deri më 22 korrik 1998 kur edhe e rimorri kontrollin e qytetit dhe gjatë këtij aksioni 79 civilë shqiptarë të qytetit të Rahovecit/Orahovac u ekzekutuan në shtëpitë e tyre, në rrugë, në vendin e punës dhe vende të ngjashme. Pas ekzekutimeve, forcat policore urdhëronin strukturat komunale që të merrnin trupat e viktimave dhe ti varrosnin në vendin e quajtur "Gropa për Bërlllog". Viktimat u varrosën në mënyre individuale një nga një dhe tek një numër prej këtyre varreve u vendosën dërrasa të drurit me emrin e viktimave apo numër identifikues por për shkak të gërmimeve të vazhdueshme me eskavator këto dërrasa identifikuese u përzihen me mbeturinat që gjendeshin aty. Kështu, këto varreza më shumë ngjanin me një hapësirë të dedikuar për hedhjen e mbeturinave sesa një vend varrezash.

Zëdhënësi i atëhershëm i policisë serbe, koloneli Bozhidar Filliq në një intervistë për mediumin CNN, dhënë në gusht 1998, kishte mohuar se ajo hapësirë ishte një vend për hedhjen e mbeturinave duke aluduar se dikush e kishte bërë rrëmuje atë vend më pastaj dhe gjithashtu kishte potencuar se trupat u varrosën aty për shkak të afërsisë me varrezat myslimane. Në anën tjetër, Koloneli Filliq kishte thënë se viktimat e varrosura në atë hapësirë ishin 'terroristë' që ishin vrarë gjatë luftimeve dhe nuk ishin viktimë civile siç aludonin shqiptarët e Kosovës. Por një gjë e tillë u demantua që në gushtin e vitit 1998 kur disa nga dërrasat identifikuese të vendosura përmbanin emra të personave civilë, si rasti i Sabrije Mullabazi e cila ishte një grua 90-vjeçare që ishte ekzekutuar në oborrin e saj dhe pastaj ishte varrosur në Gropën me Bërlllog.



Trupat e viktimave të varrosura në këtë hapësirë u identifikuan dhe u rivarrosën në periudha të ndryshme. Një grup i tyre u identifikuan menjëherë pas përfundimit të luftës, në tetor të vitit 1999 ndërsa një numër i viktimave të tjera u identifikuan dhe u rivarrosën gjatë viteve 2005-2007. Te gjithë trupat e identifikuar në këtë hapësirë u rivarrosën në varrezat e myslimanëve të qytetit të Rahovecit/Orahovac.

E ASHTUQUAJTURA 'GROPA PËR BËRLLLOG'


ÇKA KA QENË?

Gropa për Bërlllog ishte një hapësirë pranë varrezave myslimane të qytetit të Rahovecit/Orahovac ne të cilën hidheshin mbeturina të kategorive të ndryshme nga banorët e zonës para dhe gjatë periudhës së luftës 1998-1999.

E ASHTUQUAJTURA 'GROPA PËR BËRLLOG'


ÇKA ËSHTË SOT?

Pas përfundimit të luftës, në hapësirën e Gropës për Bërlllog nuk ka vazhduar hedhja e mbeturinave dhe është shndërruar në një vend të dinjitetshëm për varreza. Pra, pas ekshumimit të trupave që ishin varrosur aty në vitin 1998, hapësira e Gropës për Bërlllog i është bashkuar varrezave myslimane të qytetit të Rahovecit/Orahovac. Deri me tani, në atë hapësirë nuk ekziston ndonjë shenjëzim që tregon që e njëjta ka qenë një lokacion ku trupat e ekzekutuar të civilëve shqiptarë gjatë vitit 1998 janë varrosur në një mënyrë jo-dinjitoze në një vend ku hidheshin mbeturina në vazhdimësi.



E ASHTUQUAJTURA 'GROPA PËR BËRILLOG'

HARTA





Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo




GRADICË

BUNAPRI I PAPËRFUNDUAR

BUNARI I PAPËRFUNDUAR

GRADICË

Lufta në Kosovë zyrtarisht kishte filluar pikërisht në Komunën e Glogocit/-Glogovac, gjatë sulmeve të 28 shkurtit 1998 në fshatrat Likoshan/Likošane dhe në Qirez/Ćirez të Skënderajit/Srbica, ku humbën jetën 29 persona. Duke pasur parasysh që rajoni i Drenicës konsiderohej si vatër e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, fillimi i marsit 1998 vazhdoi të karakterizohej me luftime dhe me viktima të shumta civile dhe të forcave të armatosura.



Në komunën e Glogocit/Glogovac gjatë vitit 1998 janë vrarë dhe/apo zhdukur 229 persona si rezultat i luftës. Vetëm atë vit humbën jetën 199 shqiptarë (153 prej tyre ishin civilë), 29 serbë (9 prej tyre ishin civilë) dhe 1 bullgar si pjesëtar i forcave të armatosura serbe.

Që nga muaji prill i vitit 1998 forcat policore serbe kishin filluar të stacionoheshin përreth malit të Çiçavicës/Čičavica – zonë malore mes Vushtrisë/Vučitrn, Glogocit/Glogovac, Skënderajit/Srbica dhe Obiliqit/Obilić, ku dyshohej prania e UÇK-së. Prej datave 22 deri 27 shtator 1998, në përkrahje të policisë ishte edhe ushtria jugosllave kur edhe filloi operacioni i njohur me emrin "Çiçavica". Ky operacion ushtarak fillimisht përfshinte fshatrat e Vushtrisë duke vazhduar në ato të Glogocit/Glogovac e Skënderajit/Srbica.

Gjendja në komunat e Glogocit/Glogovac, Skënderajit/Srbica, Vushtrisë/Vučitrn dhe Obiliqit/Obilić veçse shkonte duke u përkeqësuar, qytetarët dëboheshin dhe shumë shtëpi u dogjën.

Me datën 23 shtator 1998 forcat serbe filluan sulmin në malin e Çiçavicës/Čičavica ku qindra banorë po strehoheshin aty, ndërsa të nesërmen në orët e hershme të mëngjesit ushtria hyri në brendësi të malit.



Të strehuar në malin e Çiçavicës/Čičavica ishte edhe familja Hoti. Ata ishin nga fshati Marinë/Marina e Skënderajit/Srbica por kishin lëshuar shtëpitë në qershor të vitit 1998. Ata deri më 23 shtator 1998 kishin qëndruar te të afërmit e tyre, familja Saliuka, në Gradicë/Gradica. Nga gjendja e rënduar ata u detyruan t'i lëshojnë shtëpitë dhe të nisen drejt malit të Çiçavicës/Čičavica, ku u vendosen në një tendë. Kur u strehuan në mal, disa prej burrave u ndanë nga familjet e tyre për çështje sigurie dhe u vendosën në një gropë të fshehur/bunar dhe qëndruan gjithë ditën të fshehur aty. Natën vonë ata shkuan tek tenda për ushqim dhe për pushim, ndërsa në orët e hershme të mëngjesit u kthyen në gropë.



Gropa ishte hapur për t'u ndërtuar një bunar mirëpo ishte e papërfunduar. Nuk kishte ujë dhe ishte vështirë e qasshme sepse e mbulonin shkurret. Si hapësirë ishte rreth 150 metra larg nga tenda ku ishin familjarët e tjerë.



Atë mëngjes, më 24 shtator 1998, 6 burrat ishin në bunar kur u afruan forcat serbe, të cilët i nxorën me dhunë nga aty, i rreshtuan dhe filluan t'i rrahin. Më të voglin në moshë e që ishte vetëm 12 vjeç, pasi e rrahën i thanë të largohet ndërsa 5 burrat e tjerë i vranë në mënyrë mizore.

Pjesëtarët tjerë të familjes që ishin në mal, gra e fëmijë, i dëgjuan të shtënat dhe më pas forcat serbe arritën edhe te ta, me ç'rast iu bënë disa pyetje, ua dogjën gjërat personale dhe i detyruan të largohen nga aty.

Të nesërmen, familjarët dëgjuan se disa burra ishin vrarë në malet e Çiçavicës/Čičavica. Në afërsi të bunarit ku ishin fshehur burrat i gjetën trupat e masakruar të Seferit, Rustemit, Enverit dhe Naim Hotit si dhe Mehmet Saliukajt, të cilët fillimisht i varrosën në varrezat e Gradicës/Gradica.



BUNARI I PAPËRFUNDUAR NË GRADICË

ÇKA KA QENË?

Kjo gropë në Gradicë/Gradica tek malet e Çiçavicës/Čičavica, ku ka ndodhur ngjarja tragjike e familjes Hoti dhe Saliuka, ishte hapur para luftës me qëllimin e ndërtimit të një bunari. Si i papërfunduar dhe i rrethuar me shkurre, kjo hapësirë u pa si një vend i sigurt për tu fshehur në gjendje rreziku.




BUNARI I PAPËRFUNDUAR NË GRADICË

ÇKA ËSHTË SOT?

Sot ky vend vazhdon të jetë i njëjtë, është plotësisht i mbuluar nga shkurre dhe nuk mund të shihet gropa. Gjithsesi në atë hapësirë nuk ka as mirëmbajtje e asnjë shënjim për ngjarjen e 24 shtatorit të vitit 1998, edhe pse aty ishin vrarë në mënyrë mizore 5 civilë. Mos shënjimi i vendeve të krimit kontribuon në harresë kolektive gjë që zbeh historinë dhe ngjarjet që kanë ndodhur si pasojë e luftës në Kosovë.

BUNARI I PAPËRFUNDUAR NË GRADICË

HARTA





Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo


U PRA E GEGËVE E GEGËVE E GEGËVE

PEJË

URA E GEGËVE

PEJË

Komuna e Pejës/Peć shtrihet në pjesën perëndimore të Kosovës ku në njërën anë ka fushat e gjera të rrafshit të Dukagjinit ndërsa nga ana tjetër kufizohet me malet e larta të Bjeshkëve të Rugovës. Gjatë viteve të 90-ta, Komuna e Pejës/Peć kishte një popullsi prej rreth 150.000 banorë, e cila përbëhej nga rreth 80.000 shqiptarë, 22.000 serbë dhe pjesa tjetër përbëhej nga romë, boshnjakë, egjiptianë dhe grupe të tjera më të vogla etnike.



Si pasojë e luftës në Kosovë, në komunën e Pejës/Peć gjithsej humbën jetën dhe/apo u zhdukën me dhunë 890 persona, nga të cilët 672 shqiptarë, 126 serbë, 37 boshnjakë, 24 malazezë, 16 romë, 11 egjiptian, 3 ashkalinjë dhe 1 goran. Numri më i madh i viktimave ishin viktimat civile të paarmatosura (728) të cilët u ekzekutuan në kushte dhe rrethana të ndryshme dhe shumica prej tyre gjatë periudhës mars-qershor 1999 si pasojë e ekzekutimeve në masë si: masakra në Qyshk/Ćuška, në Lubeniq/Ljubenić, në Pavlan/Pavljane, në Zahaq/Zahać, në qytetin e Pejës/Peć dhe shumë raste të tjera të ngjashme.

Më 10 qershor 1999 u arrit Marrëveshja e Kumanovës e cila i dha fund luftës në Kosovë. Megjithatë, shumë krime që u ndërlidhën në mënyrë të drejtpërdrejtë me luftën ndodhën pas arritjes së kësaj marrëveshjeje. Fondi për të Drejtën Humanitare ka regjistruar 1470 viktima të cilat janë vrarë dhe/apo zhdukur në periudhën 11 qershor 1999 - 31 dhjetor 2000 dhe që ndërlidhen me luftën e viteve 1998-1999. Numrin më të madh të këtyre viktimave e përbënin anëtarët e komuniteteve pakicë që jetonin në Kosovë dhe shqiptarët të cilët u cilësuan si bashkëpunëtorë të ish-pushtetit serb. Komuniteti boshnjakë ishte poashtu cak i krimeve të ndryshme menjëherë pas përfundimit të luftës. Në periudhën 28 shkurt 1998 - 31 dhjetor 2000, 86 civilë boshnjakë janë vrarë dhe/apo zhdukur dhe shumica prej tyre e humbën jetën dhe/apo u zhdukën pas arritjes së Marrëveshjes së Kumanovës, përkatësisht 57 prej tyre.

Pas përfundimit të luftës një pjesë e madhe e pjesëtarëve të komunitetit boshnjakë u larguan nga Kosova, ndërsa pjesa e mbetur jetuan në shtëpitë e tyre pasi nuk u ndien të rrezikuar. Ndër këto familje, ishte edhe familja Begoviq të cilët jetonin në qytetin e Pejës/Peć.





Në shtëpinë e familjes Begoviq, jetonin Hamdiu me Ifeten, së bashku me dy djemtë e tyre dhe familjet e ngushta të djemve, ku e mbarë familja kishte gjithsej 9 anëtarë. Ndërsa vajza e Hamdiut dhe Ifetes, ishte e martuar dhe jetonte me burrin e saj në Gjakovë/Djakovica.

Disa ditë pasi kishin filluar bombardimet e NATO-s, me 27 mars 1999, të dy djemtë e Hamdiut dhe Ifetes duke parë situatën, vendosën të lëshojnë shtëpinë dhe bashkë me familjet e tyre të largohen nga Kosova. Djali i madh me familje shkoi në Bosnjë dhe Hercegovinë ndërsa djali i vogël së bashku me gruan e tij u strehuan në Mal të Zi.

Hamdiu dhe Ifetja nuk u larguan dhe qëndruan në shtëpinë e tyre në Pejë/Peć. Që nga fundi i muajit mars, e deri me 12 qershor 1999, ata ishin kujdesur për shtëpitë e familjeve shqiptare në lagje. Pas përfundimit të luftës, ata nuk u larguan nga shtëpia sepse ndiheshin të sigurt.




Ditën e 9 korrikut 1999, te Ifetja dhe Hamdiu kishte ardhur për kafe fqinja e tyre. Përderisa po bënin muhabet, rreth orës 18:00, 6 persona në uniforma të UÇK-së hynë në shtëpi. Ata urdhëruan fqinjën të largohet, ndërsa qëndruan në shtëpi rreth dy orë, pastaj morën Hamdiun dhe Ifeten dhe u nisën në drejtim të panjohur.

Të nesërmen, trupat e pajetë të Hamdiut dhe Ifetes u gjetën nën urën e lumit 'Lumbardhi i Pejës' nga disa pjesëtarë të KFOR-it. Ata kishin duart e lidhura dhe ishin vvarë me nga një plumb në kokë.

Nëna e Ifetes, ka bërë identifikimin e trupave dhe 3 ditë më vonë, më 12 korrik 1999 ata janë varrosur në Vitomiricë/Vitimirica.

Për kryerjen e këtij krimi, akoma askush nuk është sjellur para ndonjë gjykate vendase ose ndërkombëtare për tu gjykuar.





URA E GEGËVE

ÇKA KA QENË?

Lumi 'Lumbardhi i Pejës' buron në Usovishtë/Usoviste në një lartësi mbidetare prej 1932 metrash dhe rrjedha e tij kalon përmes formacioneve gëlqerore të Grykës së Rugovës duke vazhduar përmes qytetit të Pejës/Peć dhe duke e ndarë atë në dy pjesë. Lumbardhit të Pejës i bashkohen përroi i Turjakës dhe përroi i Isniqit dhe si tërësi i bashkohen lumit të Drinit të Bardhë i cili derdhet në Adriatik.


Gjatë periudhës së luftës në Kosovë, në qytetin e Pejës/Peć kanë qenë tri ura kryesore të cilat kanë shërbyer për kalimin e Lumbardhit të Pejës dhe për lidhjen e pjesëve të ndryshme të qytetit. Këto tri ura janë njohur me emërtimet si: Ura e Gurit, Ura e Zallit dhe Ura e Gegëve të cilat janë ndërtuar në periudha dhe me metoda të ndryshme dhe janë rindërtuar në vitin 1979 pas vërshimeve që ndodhën në atë vit dhe i shkatërruan të njëjtat. Trupat e çiftit Begoviq u gjenden pikërisht nën urën e Gegëve.

Ura e Gegëve gjendet në pjesën perëndimore të qytetit të Pejës dhe lidh pjesën e qytetit me lagjen Kapeshnicë. Emri i saj rrjedh nga familja me mbiemrin Gegaj të cilët jetojnë në Kapeshnicë dhe në këtë mënyrë ka marr emrin Ura e Gegëve/Gegiqve. Ura e Gegëve ishte një urë e ngushtë e cila fillimisht ishte një urë e drurit dhe pas shkatërrimit të saj si pasojë e vërshimeve të vitit 1979 e njëjta u rindërtua pastaj me material të metalit dhe përdorej vetëm për qarkullimin e këmbësorëve.


URA E GEGËVE

ÇKA ËSHTË SOT?

Ura e Gegëve është rinovuar pas luftës duke marrë një formë me moderne por vazhdon të ketë funksionin e njëjtë duke u përdorur vetëm për qarkullimin e këmbësoreve dhe duke lidhur qytetin e Pejës me Kapeshtnicën. Por përkundër faktit se nën këtë urë janë gjetur trupat e çiftit Begoviq, të cilët ishin civilë të pa armatosur, akoma nuk ekziston ndonjë shënim i cili do të informonte qytetarët lidhur me këtë ngjarje që ka ndodhur në korrikun e vitit 1999.



URA E GEGËVE, PEJË HARTA





Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo


SHITËPIJA E KULTURËS

GLLOGOC

SHTËPIA E KULTURËS

GLLOGOC

Komuna e Gllogocit/Glogovac është një nga komunat më të dëmtuara si rezultat i luftës në Kosovë. Në atë kohë aty jetonin rreth 69,000 banorë me shumicë shqiptare. Gjatë viteve 1998-2000, në komunën e Gllogocit/Glogovac u vranë dhe/apo u zhdukën 1078 persona, prej tyre 960 ishin shqiptarë, 107 serbë dhe 11 nga komunitetet tjera.



E pozicionuar në qendër të Kosovës dhe e rrethuar nga malet e Çiçavicës dhe kodrat e Drenicës, në këtë zonë u zhvilluan edhe luftimet e para në mes forcave serbe dhe forcave të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Përveç vrasjeve dhe zhdukjeve të civilëve, në këtë komunë ishin të zakonshme edhe ndalimet arbitrare, maltretimi i të ndaluarve dhe puna e detyruar për të njëjtit, të cilat u intensifikuan dukshëm pas fillimit të intervenimit të NATO-s në Kosovë.

Shtëpia e Kulturës e cila është objekti i parë karshi Stacionit të Policisë në këtë komunë, është një nga objektet që shërbeu si një vend për mbajtjen e të ndaluarve shqiptarë dhe maltretimin e të njëjtëve.

Që nga viti 1998 e deri në fund të luftës, forcat serbe ndjekën të njëjtin model të maltretimeve në stacion dhe në Shtëpinë e Kulturës.

Arrestimet në masë dhe mbajtjet e të arrestuarve në Shtëpi të Kulturës u rritën në muajin prill, maj e deri në fillim të qershorit të vitit 1999. Të ndaluarit silleshin aty në grupe, të vogla apo të mëdha. Një ndër grupet më të mëdha që ishin sjellë në atë objekt, ishin banorët e fshatrave Shtuticë/Štutice, Vërboc/Vrbovac, Tërstenik/Trstenik, Polluzhë/Poluže, Baks, Gllanasellë /Gladnoselo, Qirez/Ćirez, Dashec/Daševce etj., të cilët ishin arrestuar gjatë ofanzivës së forcave serbe në territoret e këtyre fshatrave më 30 prill të vitit 1999. Gjatë kësaj ofanzive të forcave serbe ishin vrarë mbi 140 shqiptarë, shumica prej tyre civilë. Një pjesë e madhe e meshkujve ishin ndaluar, dërguar dhe mbyllur në xhaminë e Qirezit. Të nesërmen, me datë 1 maj 1999, ata ishin bartur me disa kamionë nga Xhamia e Qirezit në drejtim të Glllogocit/Glogovac. Në fshatin Çikatovë e





Vjetër/Staro Čikatovo, në vendin e quajtur Shavarinat/Šavarine, janë ekzekutuar 118 prej tyre. Pjesa tjetër, pas përjetimeve të tmerrshme të atyre ditëve, dhe të frikësuar për jetën e tyre, ishin dërguar në hapësirat e Shtëpisë së Kulturës në Glllogoc/-Glogovac.


Shqiptarët civilë të arrestuar në qytetin e Glllogocit e në fshatrat përreth mbaheshin në Shtëpinë e Kulturës në kushte ç'njerëzore dhe

trajtoheshin në mënyrë mizore. Shumë njerëz mbaheshin në hapësira të ngushta, kishte raste kur në dhomën e vogël të garderobës ishin mbi 150 persona, të ulur njëri mbi tjetrin. Atyre nuk iu jepej ushqim e as ujë ndërsa me raste nuk kishin as ajër të mjaftueshëm.

Në një rast i cili ka ndodhur në fund të prillit 1999, personat të cilët ishin mbyllur në hapësirat e Shtëpisë së Kulturës kanë kërkuar nga pjesëtarët e forcave serbe që ti hapnin dritaret



sepse kishin mbetur pa ajër. Pas pak kohe dikush nga pjesëtarët e forcave serbe i thyen xhamat e dritareve duke i kërcënuar që të mos tentojnë të largohen sepse janë nën vëzhgim. Përveç mbajtjes së të ndaluarve në kushte ç'njerëzore dhe trajtimit mizor, ata ishin edhe objekt i torturimit brenda Shtëpisë së Kulturës. Shpesh goditeshin me grusht, shqelma, shkopinj dhe kablo të rrymës elektrike. Ndonjëherë, turmat e të ndaluarve detyroheshin të dilnin në oborrin e Shtëpisë së Kulturës dhe të qëndronin të ulur apo në gjunjë, me duar të mbajtura prapa kokës për një kohë të gjatë.



Të ndaluarit që merreshin në pyetje nga ana e pjesëtarëve apo inspektorëve të policisë, dërgoheshin në hapësirat e stacionit policor i cili ishte karshi Shtëpisë së Kulturës apo dërgoheshin në stacionin hekurudhor i cili ishte shumë afër. Të gjithë ata që u dërguan për tu marr në pyetje ishin rrahur dhe torturuar gjatë marrjes në pyetje. Pastaj ata ktheheshin prapë në hapësirat e Shtëpisë së Kulturës.

Shumë nga ta janë dërguar pastaj në burgun e Lipjanit e me 10 qershor 1999 janë dërguar në burgjet serbe. Një pjesë prej tyre janë dërguar në punë të

dhunshme në fshatra të ndryshme, duke përfshirë fshatin Krajkovë/Krajovo, ku kanë hapur istikame dhe kanë bërë punë tjera. Një numër më i vogël prej tyre pas mbajtjes disa ditore në shtëpinë e Kulturës janë liruar.

Shtëpia e Kulturës në Glllogoc/Glogovac është një rast i rrallë ku në një objekt të kulturës janë mbajtur dhe keqtrajtuar në mënyra brutale qindra civilë të pafajshëm.



SHTËPIA E KULTURËS

ÇKA KA QENË?

Shtëpia e Kulturës ka filluar së funksionuari në muajin maj të vitit 1970, ku para luftës janë mbajtur aktivitete të shumta kulturore. Aty janë mbajtur koncerte nga Shoqëria Kulturore 'Shote Galica', shfaqje të filmave e shfaqje teatrore dhe janë organizuar edhe festivale.

SHTËPIA E KULTURËS

ÇKA ËSHTË SOT?

Shtëpia e Kulturës pas luftës është rifunksionalizuar dhe shfrytëzohet nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport për mbajtjen e aktiviteteve kulturore, shfaqje të filmit, promovim librash e dokumentarësh të ndryshëm.

Shtëpia e Kulturës është aktive, dhe ka 306 ulëse. Kjo hapësirë shfrytëzohet për ushtrime nga grupet e OJQ-ve kulturore, mbajtja e festivalit 'Ditët e Humorit Drenasi', sofra poetike 'Ymer Elshani', orë letrare me karvanin e shkrimtarëve për fëmijë, festivali i grupeve muzikore me shkollat fillore me karakter garues në nivel komunal, akademi përkujtimore e promovim librash.

Megjithatë ajo nuk është funksionale në baza ditore dhe ç'është më e rëndësishmja aty nuk ka asnjë shënjim të ngjarjeve të viteve 1998 – 1999, gjë që është jashtëzakonisht e rëndësishme të shënohet si vend i krimit duke pasur parasysh që qindra persona gjatë atyre viteve janë mbajtur me dhunë e keqtrajtuar. Kultivimi i kulturës së moskujtimit rrezikon që kjo periudhë të harrohet ose të kujtohet vetëm nga personat e prekur përderisa do të duhej që ky rast të jetë pjesë e kujtesës kolektive dhe të memorializohet.



SHTËPIA E KULTURËS

HARTA





7. BURIMET

Toma M. (2020). Procesi i Përkujtimit nga Këndvështrimi i të Rinjve, Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, fq.11.

Shaeed F. (2014). Raporti i Raportuesit Special në fushën e të Drejtave Kulturore – Proceset e Përkujtimit, Kombet e Bashkuara, para. 13. <https://www.ohchr.org/en/calls-for-input/reports/2014/report-memorization-processes-post-conflict-and-divided-societies>

Hamber B. & Ševčenko L. & Naidu E. (2010). Ëndërr utopike apo mundësi praktike? Sfidat e Vlerësimit të Ndikimit të Memorializimit në Shoqëritë në Tranzicion, The International Journal of Transitional Justice, vol.4, fq.398. <https://academic.oup.com/ijtj/article/4/3/397/2357022?login=true>

Barsalou J. & Baxter V. (2007). Nxitja për të kujtuar, Roli i Memorialeve në Rindërtimin Social dhe Drejtësinë Tranzicionale. Seritë për Stabilizim dhe Rindërtim, nr.5, fq.13. <https://www.usip.org/sites/default/files/resources/srs5.pdf>

Baliqi B. (2016). Kujtimet e ndara - rinia e ndarë: Si ndikon kujtimi i luftës në identitetin etnik dhe qëndrimet politike në mesin e të rinjve në Kosovë? fq.1. <https://www.semanticscholar.org/paper/Divided-memories-divided-youth-%3A-How-war-affects-in-Baliqi/198f0474a144cf4434c00172379a3105ba7aed6f>

UNHCR (2000). Kriza e refugjatëve në Kosovë, një vlerësim i pavarur i gatishmërisë dhe reagimit ndaj emergjencave të UNHCR-së. fq.6. <https://www.unhcr.org/3ba0bbeb4.pdf>

UNHCR (1999). Kosova: Një mundësi e fundit. fq.7. <https://www.unhcr.org/3c6914bc5.pdf>

Ligji Nr. 04/L-146 Për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, art.3-4, (2013). <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=8657>

Ligji Nr. 06/L-059 Për Komplexin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz, art.1, (2018). <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18130>

Rregullore (QRK) - Nr. 01/2021 Për Rregullat dhe Mënyrën e Sjelljes së Vizitorëve në Hapësirat e Kompleksit Memorial "Adem Jashari" në Prekaz. (2021). <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=36549>

Ligji Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale (2008). <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2530>

Rregullorja (Komuna e Vushtrrisë) Nr. 331/12 për procedurat dhe kriteret për vendosjen dhe mirëmbajtjen e monumenteve, busteve, simboleve dhe pllakave përkujtimore. (R-01-331/12-K.VU, 2012).

Webfaqja Zyrtare e Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës. <https://amkmk.rks-gov.net/>

Haxhijaj S. (2021). Të parregulluara e pa legalizuara, memorialet e luftës mbushin qytetet e Kosovës. BIRN. <https://balkaninsight.com/sq/2021/03/26/te-parregulluara-e-pa-legalizuara-memorialet-e-luftes-mbushin-qytetet-e-kosoves/>

Baliqi B. (2017). Pasojat e Përvojave të Luftës në Gjenerimin e Kosovës në Lëvizje – Kujtesa Kolektive dhe Marrëdhëniet Etnike në mesin e të Rinjve në Kosovë. Zeitgeschichte. Fq.6.19 https://www.researchgate.net/publication/320373041_The_Aftermath_of_War_Experiences_on_Kosovo's_Generation_on_the_Move-Collective_Memory_and_Ethnic_Relations_among_Young_Adults_in_Kosovo

Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë (2020), Parimet për Ballafaqimin me të kaluarën, Parimi: Barazia, Përfshirja dhe Pajtimi duhet të promovohen nga të gjithë – rast studimor. <https://www.hlc-kosovo.org/storage/app/media/Princip-i%203%20Barazia%20gjith%C3%ABp%C3%ABrfshirja%20dhe%20pajtimi%20duhet%20%C3%AB%20promovohen%20nga%20t%C3%AB%20gjith%C3%AB/case-studies-equality-inclusion-and-reconciliation-should-be-promoted-by-all.pdf>

Parimet për ballafaqimin me të kaluarën është një nismë qytetare e promovuar nga një grup praktikuesish dhe organizatash të shoqërisë civile në fushën e Ballafaqimit me të kaluarën. Grupi filloi një nismë të përbashkët për të hartuar dhe miratuar një sërë parimesh që do të informojnë dhe udhëzojnë aktorët politikë dhe publikë se si të angazhohen me viktimat, të mbijetuarit, të kaluarën e dhimbshme dhe tregimet historike. Nisma synon të parandalojë diskursin dhe veprimet e dëmshme që lidhen me trashëgiminë e konfliktit dhe do të shërbejë si një dokument referimi ndaj të cilit kushdo që shkel parimet e tij duhet të mbahet moralisht përgjegjës. <https://yihr-ks.org/site/wp-content/uploads/2021/01/Principi-Eng.pdf>

Fazliu E. & Robinson J. (2021). Serbët janë përjashtuar nga një memorial në Kosovë kushtuar viktimave të sulmit të NATO-s, BIRN. <https://balkaninsight.com/2021/05/05/serbet-perjashtohen-nga-memoriali-ne-kosove-kushtuar-viktimave-te-sulmit-te-nato-s/?lang=sq>

FDH Kosovë (2019). Ekspozita "Na ishte një herë që kurrë mos qoftë". <https://www.hlc-kosovo.org/en/dck>

Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut Kosovë (2021). Muzeu Virtual i Refugjatëve. <https://museumofrefugees-ks.org/?lang=en>

BIRN (2021). Toka e Hidhur. <https://balkaninsight.com/2021/06/03/birn-launches-data-base-of-mass-graves-from-yugoslav-wars/>
<https://massgravesmap.balkaninsight.com/>

OSCE (1999). Kosova: Si duket dhe si tregohet. <https://www.osce.org/files/f/documents/d/d/17772.pdf>

Human Rights Watch (1999). Nën urdhra. <https://www.hrw.org/reports/2001/kosovo/>

CNN (1998). Raporte të mohimit të një varrezë masive. <http://edition.cnn.com/WORLD/europe/9808/05/kosovo.02/index.html>

Dinmore G. (1998). Kosovë: zbulimi i një masakre. <https://archive.macleans.ca/article/1998/8/17/kosovo-a-massacre-revealed>

Associated Press (1998). Kosovw: Rahovec: 36 trupa gjinden të varrosur në një gropë me bërlog. <https://www.youtube.com/watch?v=OOmtvsiZ1ww>

Gjykimi i TPNJ, Rasti Nr. IT-05-87-T, fq. 193-194

Fondi për të Drejtën Humanitare (2017). Dosja: Fshehja e provave të krimeve të kryera në luftën në Kosovë: Operacioni për fshehjen e trupave. https://www.hlc-rdc.org/wp-content/uploads/2017/01/Dosije_OPERACIJA_SKRIVANJA_TELA._eng.pdf

Batajnica, Nisma për Memorialin. <https://www.batajnicamemorialinitiative.org/en/inicijativa>

Stojanovic M. & Bami Xh. (2020). Gjenden në Serbi varreza masive të dyshuara për viktima të luftës në Kosovë.

BIRN. <https://balkaninsight.com/2020/11/17/suspected-mass-grave-of-kosovo-war-victims-found-in-serbia/>

SHBA, Raport i Departamentit të Shtetit (1999). Pastrimi Etnik në Kosovë: Një Llogaritje. https://1997-2001.state.gov/global/human_rights/kosovoii/atrocit.html

The Irish Times (1999). Ekipi britanik i mjekësisë ligjore ka gjetur në Kosovë një varrezë masive me 50 trupa. <https://www.irishtimes.com/news/british-forensic-team-finds-kosovo-grave-with-50-bodies-1.223253>

Stojanovic M. (2020). Gjenerali i policisë serbe mohon njohuritë për rolin e Njësisë së Sigurimit në Luftë. BIRN. <https://balkaninsight.com/2020/09/24/serbian-police-general-denies-knowledge-of-security-units-war-role/>


TPNJ (2014). Sainovic et al. (IT-05-87). <https://www.icty.org/case/milutinovic>

Physicians for Human Rights (1999). Krimet e luftës në Kosovë: Një vlerësim i bazuar në popullatë i shkeljeve të të drejtave të njeriut kundër shqiptarëve të Kosovës. https://phr.org/wp-content/uploads/1999/08/kosovo-war-crimes-1999.pdf?fbclid=IwAR3xGEL_Tby_2fEhc1UP19nkPt8wOEJF0kAcL8_b9J0Uh9PUgdT4Ny44S7g

Physicians for Human Rights (2009). Mjekësia e rrezikshme: trashëgimia e shtypjes dhe konfliktit në shëndetësi në Kosovë. <https://phr.org/wp-content/uploads/2009/06/perilous-medicine-Kosovo-legacy.pdf?fbclid=IwAR3BhMMjn6LZPTSodx0zYgU1nI3RgiHbu9MP-dFLNw09E0ruGZMHQBq9wTw>

Krasniqi S. (2018). Krimet dhe keqtrajtimi i pacientëve dhe personelit mjekësor në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës nga forcat policore dhe ushtarake të Serbisë gjatë luftës në Kosovë 1998-1999.

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit “Promovimi i Dialogut dhe Mirëkuptimit Historik”, i cili është përkrahur nga fondacioni ‘The National Endowment for Democracy’ (NED). Projekti synon të kapërcejë boshllëkun e njohurive që ekzistojnë në mesin e të rinjve në Kosovë për konfliktin e fundit në Ballkan, si dhe të bëjë përkujtimin e viktimave civile nga të gjitha përkatësitë etnike në mbarë Kosovën.



Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë
Fond za humanitarno pravo Kosovo
Humanitarian Law Center Kosovo

